**Ligji Nr. 04/-L-027**

# PËR MBROJTJE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Miraton

## LIGJ PËR MBROJTJE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA

## KREU I
## DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Qëllimi

Ky Ligj ka për qëllim mbrojtjen dhe shpëtimin e njerëzve, kafshëve, pronave, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

### Neni 2
### Fushëveprimi

1. Fushëveprimi i këtij ligji është menaxhimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, zvogëlimi i numrit të fatkeqësive, parandalimi si dhe zvogëlimi i numrit të viktimave dhe pasojave tjera nga fatkeqësitë e tilla.

2. Shteti është përgjegjës për organizimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera si sistem unik dhe integral shtetëror.

3. Sistemi i mbrojtjes nga paragrafi 2. i këtij neni përmban programimin, planifikimin, organizimin, menaxhimin, zbatimin, mbikëqyrjen, koordinimin dhe financimin e masave dhe aktiviteteve për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

### Neni 3
### Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

    1.1. **Ministria** –Ministria e Punëve të Brendshme(MPB);

    1.2. **Agjencia** - Agjencia e Menaxhimit Emergjent (AME) si agjenci ekzekutive e themeluar me ligj në kuadër të MPB-së;

1.3. **Strukturat për Mbrojtje Shpëtim dhe Ndihmë (SMSHN)**- personat fizik dhe juridik te cilët me resurset e tyre njerëzore dhe materiale në dispozicion, të destinuara për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera;

1.4. **Fatkeqësi –** një ngjarje apo pjesë të ngjarjes të shkaktuar nga forcat madhore të natyrës apo forcat tjera te pakontrolluara, të cilat rrezikojnë jetën e njerëzve, kafshëve dhe pronave, shkaktojnë dëme në trashëgiminë kulturore dhe mjedis, në përmasat e atilla që kërkojnë ndërmarrjen e masave dhe dislokimin e forcave dhe resurseve të veçanta;

1.5. **Fatkeqësi natyrore –** janë: tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, ortek, erë e fuqishme, breshër, borë me shi, acar, thatësi, zjarr fushor, shpërthim i sëmundjeve infektive që ndikojnë në njerëz, kafshë ose bimë dhe fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga forcat natyrore;

1.6. **Fatkeqësi tjera –** janë: aksidentet që përfshijnë trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, zjarret, fatkeqësitë në miniera, shkatërrimet e pendave, aksidentet nukleare dhe aksidentet tjera ekologjike dhe industriale të shkaktuara nga aktivitetet dhe veprimet e njeriut, lufta dhe gjendja emergjente, përdorimi i armëve dhe mjeteve të shkatërrimit në masë, sulmet terroriste me mjete klasike dhe forma tjera të dhunës në masë;

1.7. **Krizë -** gjendjen e sigurisë në hapësirën regjionale e më gjerë e cila nuk mund të kontrollohet me resurse dhe masa të zakonshme në të cilën janë të kërcënuara vlerat themelore të Republikës së Kosovës për shkaqe ekonomike, sociale, ushtarake dhe shkaqe tjera të cilat mund të kalojnë përtej kufijve dhe paraqesin kërcënim të pashmangshëm tek vendet tjera përkatëse;

1.8. **Aksident ekologjik -** një aksident mjedisor, sipas përcaktimit në dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit, të shkaktuar nga një ngjarje e papritur apo e pakontrolluar për shkak të ndërhyrjes në mjedis, e cila për pasoj mund të kërcënoj jetën dhe shëndetin e njerëzve apo cilësinë e mjedisit;

1.9. **Aksident industrial -** një ngjarje e cila ka dal jashtë kontrollit gjatë kryerjes së aktiviteteve apo veprimit me makineri dhe materie të rrezikshme ose të dëmshme, ku një ngjarje e tillë rezulton në kërcënimin e jetës apo shëndetin e njerëzve, kafshëve, pronave, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit;

1.10. **Materie e rrezikshme -** çdo materie në gjendje të ngurtë, të gaztë apo të lëngët, e cila me rrjedhje të pakontrolluar në mjedis paraqet rrezik të pashmangshëm për jetën apo shëndetin e njerëzve dhe kafshëve apo shkakton çrregullim apo dëmtim të pronave dhe ndikon dëmshëm në mjedis;

1.11. **Rrezik -** mundësia e dëmtimit apo kërcënimit të jetës apo shëndetit të njerëzve dhe kafshëve dhe mundësia e shkaktimit të çrregullimeve dhe dëmeve ndaj pronave, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit;

1.12. **Kërcënim -** ekspozimi real dhe i atëçastshëm i njerëzve, kafshëve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit ndaj rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.13. **Shkalla e kërcënimit -** shkalla e pritur të dëmeve dhe pasojave tjera nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.14. **Dëmi i shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera -** dëmi i drejtpërdrejt dhe kostoja e intervenimeve dhe masave të ndërmarra për zvogëlimin e pasojave dëmtuese të fatkeqësive;

1.15. **Masë parandaluese -** çdo masë të ndërmarr për parandalimin e ndodhjes së fatkeqësisë ose për lehtësimin e pasojave të dëmshme të saj;

1.16. **Mjedisi** - rrethina natyrore, ajrin, tokën, ujin, florën dhe faunën, në tërësinë e ndërveprimit dhe trashëgiminë kulturore si pjesë e rrethinës që e ka krijuar njeriu;

1.17. **Trashëgimia kulturore -** ndërtesat dhe pjesët e ndërtesave, anekset, ngastrat e tokës, vendbanimet, vegjetacionin dhe format tjera natyrore të krijuara nga njeriu, objektet kulturore dhe historike objektet e palëvizshme të trashëgimisë kulturore, objektet lëvizëse dhe koleksionet e gjësendeve me vlera kulturore për shtetin objekte të lëvizshme të trashëgimisë kulturore;

1.18. **Mobilizim -** procedurat dhe aktivitetet për alarmimit te Strukturave për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe forcave tjera të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës me qëllim të qenit të gatshëm për kryerjen e detyrave në gjendje lufte apo në raste tjera emergjente.

1.19. **Aktivizim -** procedurat dhe aktivitetet për ngritje dhe dislokim të organizuar të mekanizmave te shërbimeve Emergjente dhe Strukturave për Mbrojtje dhe Shpëtim, resurseve në operacionet e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;

1.20. **Paralajmërim -** procedurat dhe aktivitetet për njoftimin e popullatës, komunitetit lokal, autoriteteve kombëtare, ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera, duke përdorur sinjale zanore nëse ekziston rreziku nga fatkeqësia natyrore apo fatkeqësia tjetër si dhe aktivizimin e njësive, shërbimeve dhe strukturave operative të caktuara për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;

1.21. **Reagimi Emergjent** – aktivitetet te cilat adresojnë efektet e shpejta dhe te drejtpërdrejta te një incidenti, duke i përfshirë veprimet e menjëhershme për ruajtjen e jetës, te mirave materiale dhe mjedisit, plotësimin e nevojave elementare njerëzore si dhe mirëmbajtjen e strukturës sociale, ekonomike dhe politike te komunitetit te goditur.

1.22. **Resurset për mbrojtje - shpëtim dhe ndihmë -** të gjitha burimet njerëzore, teknike, materiale dhe financiare, duke përfshirë mjetet dhe pajisjet për mbrojtje dhe shpëtim, objektet e strehimit dhe mjetet tjera të mbrojtjes, mjetet dhe pajisjet për trajnim, depot, mjetet e transportit, mjetet për komunikim dhe njoftim, të destinuara për tu përdor apo të përdorura në mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;

1.23. **Mjetet dhe pajisjet për mbrojtje dhe shpëtim -** mjetet për mbrojtje personale dhe kolektive, pajisjet, automjetet dhe mjetet tjera teknike të nevojshme për ekspertë, njësi të shpëtimit, shërbimet dhe resurset në operacionet e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

1.24. A**rtikujt e ndihmës -** ushqimin, ujin e pijshëm, veshmbathjen, medikamentet pajisjet strehuese dhe të tjera të destinuara për shpërndarje pa pagesë tek popullata e rrezikuar apo e goditur si ndihmë për lehtësimin e pasojave të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësive tjera;

1.25. **Vlerësimi i rrezikut -** analizat cilësore dhe sasiore të rrethanave natyrore dhe të tjera të lidhura me ndodhitë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, përfshirë vlerësimin e drejtimit të mundshëm të zhvillimit dhe pasojave të mundshme nga fatkeqësia, nivelin e propozuar të mbrojtjes nga rreziqet përkatëse dhe propozimin për masat parandaluese dhe të tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;

1.26. **Plani i reagimit emergjent -** plani për mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmë në rast të fatkeqësisë së caktuar të hartuar në bazë të vlerësimit të rreziqeve dhe të gjeturave të ekspertëve;

1.27. **Personi përgjegjës për shkaktimin e fatkeqësisë -** çdo person fizik apo juridik i cili e shkakton fatkeqësinë me veprim apo mos veprim;

1.28. **Personi i panjohur përgjegjës për shkaktimin e fatkeqësisë -** çdo person fizik apo juridik i cili e shkakton fatkeqësinë identiteti i të cilit është i panjohur për organet përgjegjëse në kohën kur zhvillohen operacionet e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;

1.29. **Mbrojtja -** masat organizative, teknike dhe të tjera, përdorimin e mjeteve teknike dhe të tjera për mbrojtje të menjëhershme personale dhe kolektive të njerëzve, kafshëve, pronave, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit kundër pasojave të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.

1.30. **Shpëtimi -** masat dhe procedurat për shpëtimin e njerëzve, kafshëve, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga pasojat e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera;

1.31. **Ndihma -** masat dhe shërbimet e specialistëve, njësive dhe shërbimeve të shpëtimit, përdorimin e pajisjeve dhe mjeteve për ndihmë.

1.32. **Ndihma e parë -** trajtimin fillestar të personave të lënduar dhe sëmurë, jeta dhe shëndeti i të cilëve është në rrezik nga pasojat e fatkeqësisë natyrore apo fatkeqësisë tjetër të ndodhur në fushë dhe jashtë institucioneve shëndetësore në kuadër të operacioneve të shpëtimit;

1.33. **Kushtet elementare për jetë -** në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, nënkupton kujdesin mjekësor emergjent për njerëzit dhe kafshët, strehimin, ujin e pijshëm, ushqimin, medikamentet dhe nevojat tjera për jetën dhe shëndetin e popullatës së goditur;

1.34. **Zonë -** sipërfaqe e integruar gjeografike, urbane apo tjetër e cila përfshinë dy apo më shumë komuna të cilat për qëllime të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera që përfaqësojnë një tërësi;

1.35. **Strehimore -** një objekt apo pjesën e një objekti i cili është i ndërtuar dhe pajisur me mjete të ajrosjes dhe me pajisjet tjera esenciale të banimit, të cilat ofrojnë akomodim dhe mbrojtje nga fatkeqësitë natyre dhe fatkeqësitë e tjera;

1.36. **Qytetari –** shtetasi i Republikës së Kosovës apo i huaji për qëllime të këtij ligji.

**Neni 4**
**Detyrat themelore të sistemit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera**

1. Detyrat themelore të sistemit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera janë:

1.1. zbulimi, monitorimi dhe hulumtimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.2. parandalimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.3. njoftimi, paralajmërimi dhe alarmimi për rrezikun e pashmangshëm dhe dhënia e udhëzimeve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;

1.4. trajnimi dhe aftësimi profesional për detyrat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;

1.5. organizimi i gatishmërisë emergjente, krijimi dhe mirëmbajtja e formave tjera të gatishmërisë për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;

1.6. vetëmbrojtja, vetë ndihma dhe ndihma reciproke;

1.7. mobilizimi dhe aktivizimi i mekanizmave për mbrojtje dhe shpëtim dhe Strukturave për mbrojtje dhe shpëtim, resurseve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;

1.8. përcaktimi dhe zbatimi i masave mbrojtëse;

1.9. shpëtimi dhe ndihma;

1.10. rimëkëmbja nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera deri te sigurimi i kushteve elementare për jetë;

1.11. vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.12. bashkëpunimi ndërkombëtar lidhur me zbatimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.13. mbikëqyrja e zbatimit të rregullave për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
1.14. dhënia e ndihmës për vendet tjera në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

**Neni 5**
**Mbrojtja dhe Shpëtimi**

1. Mbrojtja dhe shpëtimi organizohen si element integral i Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Emergjencave.

2. Mbrojtja, shpëtimi dhe aktivitetet tjera të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera janë të natyrës humanitare dhe jo ushtarake.

**Neni 6**
**Njoftimi për rrezikun**

Çdo person është i obliguar që ta njoftoj qendrën më të afërt emergjente ose policinë për çdo rrezik nga fatkeqësitë natyrore apo fatkeqësitë tjera sa më shpjet që e vëren apo kupton për të.

**Neni 7**
**Subjektet për ofrimin e mbrojtjes**

1. Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera sigurohet nga:

1.1. qytetaret të cilët jetojnë në Republikën e Kosovës;

1.2. personat e organizuar vullnetarisht në klube, shoqata profesionale dhe organizata tjera joqeveritare të përfshira në aktivitetet e lidhura me mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.3. shërbimet e shpëtimit;

1.4. ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera;

1.5. organet e qeverisjes lokale; dhe

1.6. shteti, brenda autoritetit ose të drejtat dhe përgjegjësitë e tij përkatëse.

**Neni 8**
**Zbatimi i mbrojtjes dhe bashkëpunimi ndërkombëtar**

1. Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera zbatohet si nënsistem unik i sistemit kombëtar të sigurisë dhe ndërlidhet me nënsistemet tjera të sigurisë në nivel lokal, rajonal dhe qendrorë.

2. Shteti zbaton mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, duke luajtur një rol aktiv në mekanizmat ndërkombëtar të bazuar në traktatet ndërkombëtare, në veçanti nëpërmjet njoftimit reciprok të rreziqeve dhe pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe ndihmave reciproke në rastet e fatkeqësive të tilla.

3. Shteti përkrah bashkëpunimin me autoritetet ndërkombëtare ne fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, duke nënshkruar marrëveshjet ndërkombëtare, posaçërisht me vendet fqinje, duke njoftuar vendet tjera për rreziqet dhe pasojat e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera dhe duke ofruar ndihmë në rastet e fatkeqësive të tilla

**Neni 9**
**Pajtueshmëria me të drejtën ndërkombëtare**

Çdo formë e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera duhet të bazohet dhe zbatohet në pajtueshmëri me parimet e së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe së drejtës ndërkombëtare për mbrojtje të njerëzve, kafshëve, trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit nga efektet dëmtuese dhe të obligimeve të pranuara ndërkombëtare.

**Neni 10**
**Parimi i së drejtës për mbrojtje**

1. Çdo person ka të drejtë në mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

2. Në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera mbrojtja dhe shpëtimi i jetës së njerëzve ka prioritet mbi çdo aktivitet tjetër të mbrojtjes dhe shpëtimit.

**Neni 11**
**Parimi i ndihmës**

Në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, çdo person është i obliguar të ofroj ndihmë sipas aftësive psiko-fizike .

**Neni 12**
**Parimi i informimit**

1. Informimi për rreziqet dhe aktivitetet e organeve qendrore, lokale dhe të tjerëve, përgjegjëse për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, duhet të jenë publike.

2. Organet qendrore dhe lokale detyrohen që ta njoftojnë popullatën e një zone të caktuar e cila ka rrezik të goditet nga fatkeqësia natyrore apo fatkeqësia tjetër.

**Neni 13**
**Parimi i parandalimit**

Në fushën e mbrojtjes kundër fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, organet qendrore, lokale dhe subjektet e tjera brenda kompetencave të tyre, përparësi duhet t'i japin organizimit dhe zbatimit të masave të parandalimit.

**Neni 14**
**Parimi i përgjegjësisë**

Çdo person fizik dhe juridik është përgjegjës për zbatimin e masave për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

**Neni 15**
**Parimi "hap pas hapi" i dislokimit të forcave dhe resurseve**

1. Kur në një fatkeqësi natyrore apo fatkeqësi tjetër kërkohet mbrojtja, shpëtimi dhe ndihma, nivelet lokale fillimisht do t'i dislokojnë njësitë dhe resurset e tyre vetanake.

2. Kur shkalla e fatkeqësisë apo rrezikut tejkalon kapacitetet e njësive të shërbimeve emergjente dhe resurseve aktuale të nivelit lokal apo kur ato nuk mund të sigurohen nga niveli lokal fqinjë, ato i siguron shteti nga regjionet tjera.

3. Nëse forcat dhe resurset në dispozicion janë të pamjaftueshme për tu përball me operacionet e domosdoshme të shpëtimit dhe ndihmës, atëherë, mund të kërkohet dislokimi i Forcës se Sigurisë së Kosovës dhe resurset e tyre për mbrojtje.

**KREU II**
**TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QYTETARËVE**

**Neni 16**
**Përgjegjësitë e qytetarëve**

1. Me qëllim të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera qytetarët janë të obliguar që:

1.1. të marrin pjesë në strukturat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

1.2. të ofrojnë mjete materiale.

1.3. të jenë të trajnuar dhe përgatitur për mbrojtje personale dhe reciproke dhe për zbatimin e masave të nevojshme të parandalimit.

**Neni 17**
**Ndihma në situatat e kërcënimit të jetës**

1. Çdo person është i obliguar që ta ndihmoj personin tjetër, jeta apo shëndeti i të cilit është në rrezik, gjithmonë duke mos e rrezikuar jetën dhe shëndetin e tij.

2. Nëse një person nuk është në gjendje ta ofroj ndihmën e nevojshme, ai pa vonesë duhet ta informoj shërbimin përkatës të shpëtimit apo qendrën operative emergjente apo në çfarëdo mënyre tjetër, në mënyrë që ndihma e tillë të sigurohet.

**Neni 18**
**Pjesëmarrja në Strukturat për Mbrojtje dhe Shpëtim**

Çdo qytetar i Republikës së Kosovës është i obliguar të marr pjesë në strukturat për mbrojtje dhe shpëtim përveç nëse është i caktuar për angazhim në detyra ushtarake apo profesionale.

**Neni 19**
**Pjesëmarrja vullnetare**

1. Pjesëmarrja vullnetare ne strukturat për mbrojtje dhe shpëtim është e hapur për:

1.1. meshkuj dhe femra, mbi moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare;

1.2. prindër të vetëm me fëmijë mbi moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare;

1.3. meshkuj dhe femra, të cilëve u ka pushuar obligimi nga neni 18 i këtij ligji.

2. Çdo person i cili merr pjesë vullnetarisht në strukturat për mbrojtje dhe shpëtim ka të njëjtat të drejta dhe obligime të cilat i kanë pjesëtarët e rregullt.

**Neni 20**
**Angazhimi në detyrë**

1. Shtetasi angazhohet në strukturat për mbrojtje dhe shpëtim nga një organ përkatës përgjegjës për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

2. Shtetasi i angazhuar në strukturat për mbrojtje dhe shpëtim, i lëshohet karta identifikuese e pjesëtarit për kohëzgjatjen e angazhimit.

3. Pjesëtarëve në strukturat për mbrojtje dhe shpëtim dhe shtetasve të cilëve u është dhënë statusi i përkohshëm i pjesëtarit të kësaj strukture, identifikohet duke bartur shenjen, uniformën dhe kartelat e identifikuese të strukturës për mbrojtje dhe shpëtim te angazhuar nga shteti në momente të caktuara.

4. Qytetarët që marrin pjesë vullnetarisht dhe jo profesionalisht në operacionet e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në njësitë, shërbimet dhe strukturat tjera operative të shoqatave dhe organizatave joqeveritare, kanë të njëjtat të drejta dhe obligime si pjesëtarë te rregullt të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim në gjendjet emergjente dhe të luftës dhe duhet ta identifikojnë veten me një kartë identifikuese të pjesëtarit të organizatës.

5. Kartelat dhe shenjat e identifikimit të pjesëtarit të strukturës për mbrojtje dhe shpëtim do të përdoren edhe nga nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit gjatë zbatimit të operacioneve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

6. Ministria me akt nënligjor përcakton formën dhe përmbajtjen e kartelës së identifikimit për prestarët e strukturës për mbrojtje dhe shpëtim.

**Neni 21**
**Kushtet e angazhimit**

1. Çdo shtetas i aftë për punë mund të angazhohet në mbrojtje dhe shpëtim sipas këtij ligji. Kushtet për aftësitë psiko-fizike për angazhim në mbrojtje dhe shpëtim duhet te vendosen vetëm për detyrat e posaçme dhe të rrezikshme.

2. Në struktura për mbrojtje dhe shpëtim nuk mund të angazhohen personat si në vijim:

2.1. shtetasit gjendja psiko-fizike e të cilëve nuk përputhet me kushtet e operacioneve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;

2.2. gratë shtatzëna, nënat dhe prindërit e vetëm me fëmijë nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare.

3. Ministria me akt nënligjor përcakton detyrat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës që konsiderohen të rrezikshmërisë së posaçme për të cilat kërkohet vendosja e një kushti të posaçëm psiko-fizik dhe shëndetësor.

**Neni 22**
**Të drejtat e vullnetarëve**

1. Personat të cilët janë të përfshirë vullnetarisht dhe jo profesionalisht, në operacione të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës dhe janë të organizuar në njësi, shërbime dhe struktura tjera operative brenda shoqatave dhe organizata tjera jo qeveritare - njësi të zjarrfikjes, organizmat e Kryqit të Kuq, shërbimet e shpëtimit në male, klubet e zhytësve, organizatat e zbuluesve, klubet radio amatore dhe organizatat tjera, bazuar në planet e reagimit emergjent nuk duhet të caktohen në detyra mbrojtëse apo operacione të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim, duke marr parasysh që kushtet e përcaktuara dhe kërkesat për aftësi specifike si dhe shërbimet që ata ofrojnë brenda strukturave të tilla nuk mund të ofrohen nga pjesëtar të tjerë.

2. Personat nga paragrafi 1. i këtij neni, kanë të njëjtat të drejta dhe obligime sikurse ato të pjesëtarit të organizatave vullnetare.

3. Në gjendje lufte, njësitë, shërbimet dhe strukturat tjera operative të përmendura në paragrafin 1. të këtij neni, së bashku me strukturat për mbrojtje dhe shpëtim do të angazhohen në operacione të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

**Neni 23**
**Obligimet për trajnime**

Te gjithë pjesëtaret të cilët angazhohen në detyrat për mbrojtje dhe shpëtim paraprakisht duhet te trajnohen dhe aftësohen për ato detyra sipas legjislacionit ne fuqi.

**Neni 24**
**Thirrja**

1. Pjesëtaret e strukturave për mbrojtje dhe shpëtim mund të thirren nga organi përkatës për:

1.1. intervistë për sistemim;

1.2. trajnime themelore dhe të avancuara;

1.3. ushtrime dhe forma tjera të trajnimeve praktike;

1.4. zbatimin e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës si dhe ato të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

**Neni 25**
**Obligimet materiale**

1. Çdo qytetar duhet t'i përmbush obligimet e tija materiale duke i dhënë në përdorim strukturave përkatëse të menaxhimit emergjent në nivele lokale dhe qendrore automjetet, makinat dhe mjetet e tjera, objektet, pajisjet, burimet energjetike, të nevojshme për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera

2. Obligimi material mund t'u ngarkohet edhe personave juridik, përveç për mjetet dhe pajisjet e caktuara për qëllime të mbrojtjes apo sigurisë të destinuara për mbrojtje shëndetësore apo mbrojtjes shpëtimit dhe ndihmës sipas këtij ligji.

3. Obligimet materiale për nevoja të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera rregullohet me Akte nënligjor nga Qeveria.

**Neni 26**
**Obligimi për paraqitje**

1. Çdo person, subjekt i pjesëmarrjes në detyrat për mbrojtje dhe shpëtim apo i obligimeve materiale me rastin e thirrjes nga organi përgjegjës është i obliguar të paraqitet apo dorëzoj mjetet materiale në kohën dhe vendin e caktuar.

2. Nëse personi nuk i përgjigjet thirrjes dhe nuk e arsyeton mosardhjen, organi përgjegjës lëshon urdhër për sjellje të detyruar të tij.

**Neni 27**
**Kompensimi**

1. Pjesëtarëve të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim, gjatë kryerjes së detyrave në këto struktura, gjatë aftësimit dhe realizimit të obligimeve materiale, në bazë të thirrjes së organit kompetent, i takon kompensimi, gjegjësisht fitimi i humbur për kohën e mungesës në punë, për shkak të kryerjes së detyrave të lartshënuara, në vlerë dhe në kushte si i përcakton Qeveria e Republikës së Kosovës.

2. Të njëjtat të drejta për kompensim, i gëzojnë edhe vullnetarët që kryejnë detyra të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në njësi, shërbime dhe struktura tjera operative të shoqatave dhe organizatave jo qeveritare.

3. Nëse kryerja e detyrave ose obligimeve në strukturat për mbrojtje dhe shpëtim zgjatë më shumë se katër (4) orë, pjesëtari ka të drejtë në ushqim pa pagesë, në ngarkesë të subjektit që e ka ftuar.

4. Punëdhënësi nuk ka të drejt në shkarkimin, ndërrimin e vendit të punës apo dëmtimin e pjesëtarit të strukturës për mbrojtje dhe shpëtim, gjegjësisht qytetarit, i cili në përputhje me këtë ligj merr pjesë në zbatimin e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, për shkak të pjesëmarrjes së tij në kryerjen e këtyre detyrave.

**Neni 28**
**Mbrojtja gjatë zbatimit të detyrave**

1. Lëndimi ose sëmundja, e cila ndodh gjatë kryerjes së detyrave, gjatë trajnimeve apo gjatë përmbushjes së obligimeve materiale në strukturat për mbrojtje dhe shpëtim, trajtohet lëndim në punë ose sëmundje profesionale dhe qytetari gëzon të drejtat e tija sipas legjislacionit në fuqi.

2. Një lëndim të cilin e pëson shtetasi gjatë rrugës nga shtëpia apo nga puna për tek vendi i takimit, apo në kthim mbrapa duke e përdorur të njëjtën marshut sipas paragrafit 1. të këtij neni.

3. Vendi dhe koha e lëndimit do të përcaktohet nga organi që e ka lëshuar urdhrin për thirrje apo nga përgjegjësi i strukturave për mbrojtje dhe shpëtim, apo nga udhëheqësi i intervenimit.

4. Familja e ngushtë e pjesëtarit, që ka humbur jetën gjatë kryerjes së detyrës, apo obligimeve të tjera në strukturat për mbrojtje dhe shpëtim, ka të drejtë për pension dhe të drejtën e shpenzimeve, transportit dhe varrimit, në përputhje me rregullat për sigurim pensional, invalidor dhe sigurimin shëndetësor.

**Neni 29**
**E drejta në ndihmë të njëhershme**

1. Shtetasi gjatë realizimit të detyrave ose të obligimeve të tjera në strukturat për mbrojtje dhe shpëtim lëndohet apo sëmuret pa faj të vet, ashtu që organizmi i tij pëson invaliditet së paku 20%, sipas rregullave për invalid, ka të drejtë për ndihmë të njëhershme me para.

2. Për ndihmë të njëhershme me para, nga par 1. i këtij neni, kanë të drejtë edhe anëtarët e familjes së ngushtë të pjesëtarit, që e ka humbur jetën gjatë kryerjes së detyrës, përmbushjes së obligimeve të tjera në strukturat për mbrojtje dhe shpëtim.

3. Kushtet për përfitimin e ndihmës nga paragrafi 1. dhe 2. të këtij neni si dhe vlera përkatëse përcaktohet nga Qeveria me Akt nënligjor dhe nuk mund të jetë më e ulët se dymbëdhjetë (12) paga mesatare mujore të nëpunësit civil në gjashtë (6) muajt e fundit.

**Neni 30**
**Dëmshpërblimi**

1. Qytetari, i cili ka pësuar dëme gjatë kryerjes së detyrave dhe obligimeve tjera në operacionet e mbrojtjes dhe shpëtimit ka të drejtë kompensimi sipas këtij ligji.

2. Qytetarët dhe personat juridik, që janë të ngarkuar me obligime materiale, kanë të drejtë në kompensimin për përdorimin e mjeteve që i kanë dhënë për nevoja të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, si dhe në kompensim dëmi, nëse ato janë dëmtuar ose shkatërruar.

3. Llojet e mjeteve materiale për të cilat organi përkatës mund të përcaktoj obligim material, vlerën e kompensimit për përdorimin e tyre dhe procedurat për vlerësimin dhe shpagimin e dëmeve të pësuara do t'i përcaktoj Qeveria me akt nënligjor.

**Neni 31**
**Detyrimet ndaj dëmeve**

1. Organet kompetente janë përgjegjëse për kompensimin e dëmeve të shkaktuara ndaj personave të tretë, me qëllim apo nga pakujdesia, gjatë kryerjes së aktiviteteve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, gjatë trajnimeve dhe detyrave tjera zyrtare, të cilat lidhen me mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

2. Çdo qytetar, i cili gjatë kryerjes së detyrave shkakton dëm me dashje apo nga pakujdesia, nga paragrafi 1. i këtij neni, përgjigjet sipas legjislacionit në fuqi.

**Neni 32**
**Grumbullimi dhe mbrojtja e të dhënave personale dhe materiale**

1. Organi përkatës grumbullon, përpunon, përdor dhe mban të dhënat personale dhe materiale për:

1.1. pjesëtarët e SMSHN, nëpunësve civil në fushën e mbrojtjes dhe ndihmës si dhe vullnetarëve në zbatimin e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, emri, mbiemri, data, vendi i lindjes, adresa e përhershme dhe e përkohshme e banimit, datëlindjet e fëmijëve, të dhënat e njohurive dhe aftësive lidhur me mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, arsimim, punësimin, numrin e telefonit fiks dhe mobil si dhe resurset materiale të tyre;

1.2. pjesëtarët e SMSHN përveç të dhënave në nën-paragrafin 1.1. të këtij paragrafi, duhet të paraqesin edhe të dhënat plotësuese për datën e kontrollit të fundit të gjendjes psiko-fizike dhe shëndetësore, përgjegjësitë brenda këtyre strukturave, për qëllime të

sigurimit të përgatitjeve, mobilizimit, aktivizimit dhe dispozitave të të drejtave dhe obligimeve të pjesëtarëve SMSHN dhe forcave tjera të kësaj natyre;

1.3. llojin, kapacitetin dhe gjendjen e mjeteve të transportit dhe mjeteve tjera subjekte të obligimit material si dhe emrin, mbiemrin, adresën e shtëpisë apo të punës të pronarëve dhe përdoruesve të mjeteve të tilla, pajisjeve dhe objekteve, për qëllime të kompletimit të ekipeve, njësive dhe shërbimeve.

2. Organi përkatës mban bazën e të dhënave personale për pjesëtarët e mundshëm SMSHN, nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe ndihmës, vullnetarët, dhe personat subjekt të obligimeve materiale.

3. Mbrojtja e të dhënave të përcaktuara në këtë nen bëhet në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

**Neni 33**
**Komunikimi i të dhënave personale dhe materiale**

1. Organi përkatës mund t'i komunikoj të dhënat personale dhe materiale të përcaktuara në nenin 32 të këtij ligji tek:

1.1. autoriteti qendror dhe lokal me kërkesë;

1.2. ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera, për pjesëtarët e SMSHN, të caktuar tek ata.

2. Organet, ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera nga paragrafi 1. i këtij neni mund t'i përdorin të dhënat e tilla vetëm për qëllime të organizimit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe janë përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale sipas ligjit në fuqi.

**Neni 34**
**Burimet e të dhënave**

1. Organi përkatës duhet t'i siguroj të dhënat personale të përcaktuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nga bazat ekzistuese të të dhënave. Autoritetet dhe shërbimet që grumbullojnë të dhënat e tilla duhet t'i ofrojnë ato me kërkesë të organit përkatës.

2. Nëse të dhënat personale nuk mund të sigurohen nga bazat ekzistuese të të dhënave, organi përkatës mund t'i siguroj ato drejtpërsëdrejti nga pjesëtarët e SMSHN, organizatat e ndryshme vullnetare apo ato qeveritare dhe joqeveritare.

3. Të dhënat personale nga neni 32 i këtij ligji, duhet të asgjësohen pas kalimit të afatit të qëllimit për të cilin ato janë grumbulluar.

4. Çdo person ka të drejt, t'i shikoj të dhënat e tij të mbajtura nga organi përkatës.

5. Organi përkatës është i detyruar që ta informoj çdo person lidhur me të dhënat e tija brenda tetë (8) dite pas paraqitjes së kërkesës nga ana e tij.

**Neni 35**
**Komunikimi i ndryshimeve të të dhënave personale dhe materiale**

Pjesëtarët e SMSHN, qytetarët dhe personat juridik subjekte të obligimeve materiale janë të obliguar ta informojnë organin përkatës për çdo ndryshim të të dhënave personale dhe të të dhënave tjera të përcaktuara në nenin 32 të këtij ligji, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e ndryshimit.

## KREU III
## PËRGJEGJËSITË

### Neni 36
### Përgjegjësitë e nivelit qendror

1. Shteti është përgjegjës për:

1.1. menaxhimin e sistemit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.2. aktivitetet e zhvillimit të kërkimeve dhe plan projekteve për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.3. përgatitjen dhe zbatimin e strategjisë dhe programeve shtetërore për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.4. përpunimin e vlerësimit të rreziqeve dhe planeve shtetërore të reagimit emergjent;

1.5. organizimin dhe pajisjen e strukturave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës shtetërore;

1.6. menaxhimin e strukturave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera që godasin dy apo më tepër komuna;

1.7. organizimin dhe zbatimin e monitorimit, paralajmërimit dhe alarmimit në nivel qendrorë dhe regjional.

1.8. organizimin dhe mirëmbajtjen e sistemit unik të paralajmërimit publik;

1.9. vendosjen dhe mirëmbajtjen e komunikimit elektronik për qëllime të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës deri tek niveli lokal dhe përcaktimin e sistemit unik elektronik të komunikimit;

1.10. vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.11. organizimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të informimit dhe komunikimit për nevoja të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës derisa përfshihen komunat dhe organet menaxheriale, njësitë, shërbimet dhe strukturat tjera operative të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;

1.12. ndihmën në restaurim dhe rimëkëmbje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera me qëllim të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të njerëzve, pronave, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, parandalimin e dëmeve të ardhshme dhe sigurimin e kushteve elementare për jetë;

1.13. përpunimin e programeve të aftësimit dhe të trajnimeve në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera dhe zbatimin e programeve të rëndësisë shtetërore.

### Neni 37
### Përgjegjësitë e nivelit lokal

1. Niveli lokal është përgjegjëse për zbatimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e tij.

2. Niveli lokal është përgjegjës për:

2.1. menaxhimin e sistemit të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në nivelin lokal;

2.2. monitorimin e rreziqeve, paralajmërimin dhe alarmimin e popullatës për kërcënimet e mundshme;

2.3. pajisjen me mjete elektronike të komunikimit për nevoja të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në përputhshmëri me një sistem unik të komunikimit dhe informimit;

2.4. planifikimin dhe zbatimin e masave mbrojtëse;

2.5. përpunimin e vlerësimit të rreziqeve dhe planeve të reagimit emergjent;

2.6. organizimin, zhvillimin dhe menaxhimin e mbrojtjes personale dhe reciproke;

2.7. organizimin, menaxhimin dhe zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në nivel lokal;

2.8. përcaktimin, organizimin dhe pajisjen e njësive dhe shërbimeve komunale të SMSHN dhe organizatave tjera të kësaj fushe;

2.9. furnizimin me resurse të domosdoshme për akomodim emergjent në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera;

2.10. përpunimin dhe zbatimin e programeve trajnuese të rëndësisë lokale;

2.11. koordinimin e planeve të reagimit emergjent dhe operacioneve tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë me komunat fqinjë;

2.12. furnizimin me kushte elementare të jetës dhe restaurimit, rimëkëmbjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

2.13. identifikimin e organizatave të rëndësisë së veçantë për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në nivel lokal;

2.14. bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës sipas këtij ligji.

3. Komunat bashkëpunojnë midis tyre në kryerje të detyrave të lidhura me mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe mund t'i bashkojnë resurset e tyre dhe të krijojnë resurse të përbashkëta për tu marr me çështjet e përbashkëta në këtë fushë.

## Neni 38
## Përgjegjësitë e ndërmarrjeve, institucioneve dhe organizatave tjera

1. Institucionet dhe ndërmarrjet duhet të sigurojnë kushte dhe mundësi të nevojshme për realizimin e mbrojtjes personale dhe reciproke si dhe implementimin e masave mbrojtëse të përcaktuara me këtë ligj.

2. Institucionet dhe ndërmarrjet që përdorin, prodhojnë, transportojnë dhe deponojnë materie të rrezikshme, karburante dhe derivate të tyre dhe gazra energjetike dhe kryejnë veprimtari me

mjete të rrezikshme, obligohen që të bëjnë vlerësimin e rreziqeve dhe të hartojnë plane të reagimit emergjent në pajtim me dispozitat ligjore.

3. Institucionet dhe ndërmarrjet nga paragrafi 2. i këtij neni, me shpenzime të veta duhet të vendosin dhe të mirëmbajnë pajisjet për ndërhyrje, të organizojnë forcat e nevojshme për shpëtim dhe ndihmë, të sigurojnë lajmërimin dhe alarmimin e punëtorëve dhe të popullatës për rrezikun dhe të bashkë-financojnë aktivitetet përgatitore të nivelit lokal në proporcion me madhësinë dhe shkallën e rrezikut, të cilën e shkakton veprimtaria e tyre.

4. Përveç institucioneve dhe ndërmarrjeve nga paragrafi 2. i këtij neni, organizatat të cilat kryejnë veprimtari edukative-arsimore, sociale, mjekësore dhe të tjera që përfshijnë kujdesin apo mbrojtjen e numrit të madh të personave, janë të obliguar të përpunojnë plane të reagimit emergjent apo të zbatojnë masa parandaluese.

5. Aktivitetet dhe mjetet nga paragrafi 2. dhe 4. i këtij neni, do të përcaktohen nga Qeveria, me akt nënligjor.

**Neni 39**
**Përgjegjësitë e pronarëve dhe shfrytëzuesve**

1. Pronarët dhe shfrytëzuesit e ndërtesave të banimit janë përgjegjës për zbatimin e masave të përcaktuara te mbrojtjes sipas kreut VI dhe për sigurimin e mjeteve të nevojshme për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

2. Pronarët dhe shfrytëzuesit e trashëgimisë kulturore janë përgjegjës për zbatimin e masave të përcaktuara mbrojtëse.

3. Pronarët dhe shfrytëzuesit nga paragrafi 1. i këtij neni duhet t'u ofrojnë në dispozicion të dhënat për ndërtesat dhe shfrytëzuesit e banesave.

## KREU IV
## PROGRAMIMI DHE PLANIFIKIMI

**Neni 40**
**Projektet për hulumtim dhe zhvillim**

1. Projektet për hulumtim dhe zhvillim lidhur me mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera janë pjesë përbërëse e programit Qendror të hulumtimeve.

2. Ministria, përkatësisht Agjencia përgjegjëse për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera merr pjesë në vendimmarrje lidhur me projektet hulumtuese dhe zhvillimore që duhet të përfshihen në programin Qendror të hulumtimeve duke propozuar projektet për hulumtim dhe zhvillim që kanë të bëjnë me mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

3. Ministria, pas harmonizimit paraprak me ministritë gjegjëse për aktivitete hulumtuese, mund të financojë projekte hulumtuese dhe zhvillimore që kanë të bëjnë me mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në mënyrë te pavarur.

**Neni 41**
**Programi Qendror**

1. Qëllimi i programit Qendror është vendosja e objektivave, politikës dhe strategjisë për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

2. Programi Qendror hartohet për një periudhe pesë (5) vjeçare dhe përfshinë:

2.1. gjendjen e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

2.2. objektivat kryesore të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për periudhën që e mbulon programi Qendror;

2.3. zhvillimin e sistemeve të monitorimit, informimit, komunikimit, mbështetjes dhe sistemeve tjera për nevoja të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;

2.4. zhvillimin e aktiviteteve të parandalimit;

2.5. zhvillimin e strukturave dhe kapaciteteve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;

2.6. udhëzimet për aftësim dhe trajnim;

2.7. udhëzimet për projekte hulumtuese dhe zhvillimore;

2.8. sigurimi i mjeteve financiare dhe mjeteve tjera.

**Neni 42**
**Plani vjetor**

Detyrat e përcaktuara në Programin qendror duhet të detajizohen në planet vjetore të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera

**Neni 43**
**Programet dhe planet lokale**

Programet dhe planet e nivelit lokal për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, nuk mund të jenë në kundërshtim me programin qendror.

**Neni 44**
**Vlerësimi i rrezikshmërisë**

1. Planifikimi i aktiviteteve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, si dhe në gjendje te jashtëzakonshme, duhet të bazohen në vlerësimin e rrezikshmërisë.

2. Vlerësimin e rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, si dhe gjendjen emergjente në nivel vendi e bën Agjencia në bashkëpunim me institucionet tjera.

3. Vlerësimin e rrezikshmërisë për nivelin lokal e bën organi përgjegjës lokal.

4. Metodologjinë për vlerësimin e rrezikshmërisë e përcakton Qeveria me akt nënligjor.

**Neni 45**
**Planet e reagimit emergjent**

1. Mbrojtja, shpëtimi dhe ndihma në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera dhe në gjendje të jashtëzakonshme duhet të planifikohen nëpërmjet planeve të reagimit emergjent.

2. Qëllimi i planeve të reagimit emergjent është sigurimi i ndërmarrjes së veprimeve të organizuara dhe të koordinuara për parandalimin e fatkeqësive apo zvogëlimin e pasojave të tyre

dhe në rast të fatkeqësisë, të sigurohen sa më shpejt që të jetë e mundur kushtet elementare për jetë.

**Neni 46**
**Autoritetet e planifikimit**

1. Planet kombëtare të reagimit duhet të përgatiten nga Agjencia në bashkëpunim me institucionet e tjera përkatëse sipas fushave të përgjegjësisë.

2. Planet lokale të reagimit emergjent hartohen nga autoritetet lokale.

3. Kryetari i komunës, për plotësim mund të kërkoj nga institucionet dhe ndërmarrjet tjera, përveç atyre të përcaktuara në nenin 42 të këtij ligji, të hartojnë plane të reagimit emergjent.

4. Autoritetet përgjegjëse për planifikimin e reagimit emergjent janë përgjegjëse që planet e miratuara t'i prezantojnë para publikut.

5. Qeveria me akt nënligjor përcakton përmbajtjen dhe procedurat për përpunimin e planeve të reagimit emergjent.

**Neni 47**
**Plotësimi i planeve**

Planet e reagimit emergjent duhet të plotësohen me rastin e çdo ndryshimi në aspektin e faktorëve te rreziqeve dhe kapaciteteve të shërbimeve emergjente - organizatave dhe resurseve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, duke i marr parasysh të gjeturat dhe përvojat e reja të arritura në menaxhimin e fatkeqësive.

**KREU V**
**MONITORIMI, NJOFTIMI DHE PARALAJMËRIMI**

**Neni 48**
**Sistemi i monitorimit, njoftimit dhe paralajmërimit**

1. Me qëllim të identifikimit dhe monitorimit të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Ministria organizon një sistem unik të njoftimit, paralajmërimit, menaxhimit dhe zbatimit të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

2. Objektivat themelore të sistemit nga paragrafi 1. i këtij neni janë:

> 2.1. grumbullimi, përpunimi, analiza dhe komunikimi i të dhënave përkatëse për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, për kryerjen e detyrave tjera përkatëse për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
>
> 2.2. njoftimi dhe paralajmërimi i qytetarëve për rrezikun e pashmangshëm dhe dhënia e udhëzimeve për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
>
> 2.3. njoftimi dhe aktivizimi i personave që kryejnë detyra të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës për rrezikun dhe komunikimi i vendimeve të arritura nga organet përkatëse qe janë përgjegjëse për zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

**Neni 49**
**Skema organizative e sistemit**

1. Sistemi monitorimit, njoftimit dhe paralajmërimit përfshin:

> 1.1. rrjetin e monitorimit;

1.2. qendrat e njoftimit emergjent;

1.3. paralajmërimin.

2. Qeveria me akt nënligjor rregullon organizimin dhe operimin e sistemit të monitorimit, njoftimit dhe paralajmërimit

**Neni 50**
**Rrjeti i monitorimit**

1. Monitorimi, njoftimi dhe paralajmërimi bazohet në:

1.1. komunikimet nga individët dhe organizatat;

1.2. vrojtimet dhe komunikimet e bëra nga zjarrfikësit, shpëtimtarët malor, shpellorët, zhytësit, pylltarët, gjuetarët, peshkatarët, klubet automobilistike, klubet nautike, klubet aeronautike, kompanitë hekurudhore, rrugore dhe institucionet dhe ndërmarrjet tjera;

1.3. komunikimet nga shërbimet e monitorimit dhe vëzhgimit të themeluara për qëllime të monitorimit të kushteve meteorologjike, hidrologjike, sizmologjike, radiologjike, ekologjike dhe të tjera;

1.4. vëzhgimet e bëra nga autoritetet e kontrollit të hapësirës ajrore dhe;

1.5. shkëmbimin ndërkombëtar të informacioneve dhe të dhënave.

2. Shërbimet dhe autoritetet nga paragrafi 1. i këtij neni duhet t'i komunikojnë informacionet përkatëse për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera te qendra operative emergjente pa pagesë.

**Neni 51**
**Shfrytëzimi i të dhënave publike dhe statistikore**

1. Me qëllim të vlerësimit të rrezikshmërisë, planifikimit dhe zbatimit të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës organet qendrore dhe lokale janë të autorizuara për shfrytëzim, në bazë të fushëveprimit të tyre, të të dhënave mbi resurset, rreziqet natyrore dhe rreziqet tjera, banorët në zonat e rrezikuara, ndërtesat e banimit dhe të tjera, shërbimet publike, ndërmarrjet, shoqatat, institucionet dhe organizatat jo qeveritare, aktivitetet e të cilave janë të rëndësishme për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

2. Me qëllim të vlerësimit të rrezikshmërisë, planifikimit dhe zbatimit të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë, organet qendrore dhe lokale janë të autorizuara për shfrytëzimin, e të dhënave personale të banorëve nën rrezik, duke përfshirë numrin personal të regjistrit të qytetarit, emrin dhe mbiemrin, datëlindjen, adresën e përkohshme dhe të përhershme të banimit dhe të dhënat mbi marrëdhënien e punës.

3. Me qëllim të vlerësimit të dëmeve të dhënat e tilla mund të përfshijnë edhe detajet lidhur me pronat e luajtshme dhe të paluajtshme të dëmtuara si pasojë e fatkeqësisë.

4. Për kryerjen e detyrave organet përkatëse qendrore dhe lokale duhet të marrin dhe përpunojnë të dhëna specifike nga regjistri qendror i qytetarëve, regjistri i bizneseve të Kosovës, të gjitha regjistrat dhe shënimet dhe të dhënat lidhur me strehimin, regjistrin e të dhënave bujqësore dhe të ngjashme,në pajtueshmëri me autorizimet e dhëna.

5. Për zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në fazën e kërcënimit të menjëhershëm të fatkeqësisë apo në rast të fatkeqësisë, në mënyrë që të kryejnë rimëkëmbjen dhe sanimin pas fatkeqësisë, autoritetet qendrore dhe lokale janë të autorizuara të shfrytëzojnë të dhënat e korrigjuara mbi vendndodhjen, sasinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara nga kompanitë publike, për numrin e strehimit individual lidhur me furnizimin me ujë, sistemin e kanalizimit, energjinë elektrike, ngrohje, gaz, linjat e komunikimit, mbeturinave komunale dhe të dhëna tjera të rëndësishme për zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

6. Përveç organeve përgjegjëse qendrore dhe lokale të dhënat sipas këtij neni, mund të përdoren edhe nga organet drejtuese, udhëheqësit e shërbimeve, njësive dhe strukturave operative si dhe komandantët e incidenteve në pajtueshmëri me profesionin dhe autorizimet e tyre për zbatimin e operacioneve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në rast të rrezikut të menjëhershëm apo në rast të fatkeqësisë, të gjerësisë e cila kërkon mbrojtje dhe shpëtim të njerëzve, pasurisë, kafshëve, trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit.

7. Agjencia grumbullon dhe menaxhon të dhënat nga ky nen dhe neni 54 i këtij ligji, në bazat qendrore të të dhënave të integruara të cilat shërbejnë si bazë për planifikimin dhe njoftimin e rreziqeve dhe zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në rastet e fatkeqësive në tërë vendin apo në pjesët e veçanta të vendit dhe duhet të ofrojnë qasje në këto të dhëna për autoritetet përkatëse qendrore dhe lokale si dhe për përgjegjësitë e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës të përcaktuar në paragrafin 5. të këtij neni. Me kërkesë të Agjencisë, të dhënat e tilla duhet të dorëzohen nga menaxherët e bazave të të dhënave të cilat financohen nga parat publike dhe në versionin elektronik.

8. Autoritetet qendrore dhe lokale, organet drejtuese, udhëheqësit e shërbimeve, njësitë dhe strukturat tjera operative dhe komandantët e incidenteve të cilët planifikojnë dhe zbatojnë mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë janë të obliguar të sigurojnë mbrojtje të të dhënave personale në përputhje me legjislacionin ne fuqi.

**Neni 52**
**Bazat e të dhënave**

1. Me qëllim të marrjes me çështje administrative dhe teknike Agjencia grumbullon, përpunon, komunikon dhe përdor të dhëna për:

1.1. fenomenet natyrore

1.2. burimet e rreziqeve të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera;

1.3. fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera si dhe dëmet e shkaktuara nga ato;

1.4. strukturat dhe resurset e tyre të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;

1.5. intervenimet nga strukturat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;

1.6. shpenzimet për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

2. Autoritetet qendrore, lokale, institucionet dhe organizatat tjera, organet drejtuese dhe komandantët e incidenteve janë të obliguar t'i komunikojnë të dhënat nga paragrafi 1. i këtij neni, sipas formës së përcaktuar dhe pa pagesë te Agjencia, ku ato integrohen në bazën qendrore të të dhënave dhe bëhen të arritshme për të autorizuarit.

3. Të dhënat përdoren edhe për përpunimin e programeve për rimëkëmbje dhe sanim pas fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.

4. Metodologjia e grumbullimit, përpunimit, mbajtjes dhe komunikimit të të dhënave përcaktohen me akt nënligjor i nxjerr nga ministria, ndërsa shkëmbimi i të dhënave me vendet e huaja dhe organizatat ndërkombëtare do të rregullohen me marrëveshje ndërshtetërore.

**Neni 53**
**Përdorimi i komunikimit elektronik**

1. Përdorimi i komunikimit elektronik me qëllim të mbajtjes dhe transferimit të të dhënave brenda sistemit të monitorimit, njoftimit dhe paralajmërimit ka prioritet mbi çdo lloj tjetër të komunikimit.

2. Me qëllim të menaxhimit dhe zbatimit të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës dhe detyrave tjera operative brenda fushëveprimit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera Ministria do të krijoj një sistem autonom të komunikimit elektronik.

**Neni 54**
**Organizimi dhe veprimi i Qendrave Operative Emergjente**

1. Me qëllim të kryerjes së detyrave operative dhe të komunikimit lidhur me monitorimin, njoftimin dhe paralajmërimin në kuadër të Agjencisë, Ministria themelon qendrat operative emergjente.

2. Në këto qendra përfshihen:

2.1. qendra Operative e Agjencisë;

2.2. qendrat Operative Emergjente Regjionale dhe;

2.3. qendrat Operative Emergjente Lokale.

3. Qendrat operative emergjente lokale mirëmbahen nga Kuvendet Komunale, dhe janë aktive dhe operative vetëm në rastet fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera apo në gjendje te jashtëzakonshme.

4. Vendimi për aktivizimin e Qendrës Operative Emergjente lokale merret nga Kryetari i Komunës me kërkesën e menaxherit emergjent lokal apo komandantit të incidentit.

**Neni 55**
**Puna e qendrave operative emergjente dhe transmetimi i informatave emergjente**

1. Qendra Operative e Agjencisë dhe Qendrat Operative Emergjente Regjionale të Agjencisë, operojnë pandërprerë njëzetekatër (24) orë në ditë , shtatë (7) ditë në javë.

2. Qendrat Operative Emergjente Regjionale pranojnë, përpunojnë dhe transferojnë thirrjet emergjente nga numri 112 që kërkojnë ndihmën e zjarrfikësve, shërbimeve mjekësore emergjente, ndihmën e shërbimeve tjera të shpëtimit dhe aktivizojnë strukturat e reagimit emergjent, në përputhje me planet e reagimit emergjent, planet e aktivizimit dhe vendimet e autoriteteve përkatëse.

3. Kërkesat e drejtpërdrejta, apelet, njoftimet dhe udhëzimet në rastet e paralajmërimit, si dhe komunikimet tjera lidhur me rrezikun duhet të komunikohen nëpërmjet Qendrave Operative

Emergjente Regjionale me kërkesën e Qeverisë së Kosovës, Kryetarit të Komunës, Komandantit te Incidentit si dhe autoritetit qendror dhe lokal përgjegjës.

4. Komunikimet nga paragrafi 3. i këtij neni publikohen pa vonesë dhe pa pagesë, sipas Ligjit për Media.

5. Publikimi i apeleve urgjente, njoftimeve dhe porosive tjera kanë prioritet në çdo shtëpi mediale.

**Neni 56**
**Sistemi i paralajmërimit**

1. Paralajmërimi organizohet si sistem unik i paralajmërimit publik i cili menaxhohet në nivelin qendror, regjional dhe lokal.

2. Paralajmërimet në raste të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera duhet të zbatohen nga Qendrat Operative Emergjente dhe shërbimet përkatëse të institucioneve dhe organizatave tjera mbi bazën e informacioneve të verifikuara apo me kërkesë të komandantëve të incidenteve, dhe organeve tjera drejtuese.

3. Institucionet dhe organizatat tjera janë të obliguara për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe sigurimin e funksionimit të mjeteve të paralajmërimit të cilat mundësojnë paralajmërimin e qytetarëve të rrezikuar drejtpërsëdrejti nga fatkeqësitë.

4. Mjetet paralajmëruese nga paragrafi 3. i këtij neni duhet të integrohen në sistemin e paralajmërimit publik të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni.

5. Ministria është përgjegjëse për organizimin, mirëmbajtjen dhe operimin e sistemit unik të paralajmërimit në nivel vendi.

6. Ministria me akt nënligjor përcakton llojin, numrin dhe përdorimin e sinjaleve alarmuese që do të aplikohen në tërë territorin e vendit.

**KREU VI**
**MASAT MBROJTËSE**

**Neni 57**
**Masat mbrojtëse**

1. Masat mbrojtëse ndër të tjera përfshinë:

1.1. masat hapësinore, urbanistike, ndërtimore dhe masat tjera teknike;

1.2. evakuimin;

1.3. akomodimin dhe kujdesin e njerëzve të rrezikuar;

1.4. mbrojtjen radiologjike, kimike dhe biologjike;

1.5. strehimin;

1.6. mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

**Neni 58**
**Masat hapësinore, urbanistike, ndërtimore dhe masat tjera teknike**

1. Masat hapësinore, urbanistike, ndërtimore dhe masat e tjera teknike, ndërmerren gjatë planifikimit hapësinor, urban dhe ndërtimor me qëllim të parandalimit apo zvogëlimit të efekteve të dëmshme si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera si dhe për të mundësuar mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën.

2. Projektet për ndërtimin e objekteve, të destinuara për shfrytëzim kolektiv, furnizim të qytetarëve, transport publik, si dhe deponim, prodhim dhe përdorim të materieve të rrezikshme, të naftës dhe të derivateve të saj, si dhe të gazrave energjetike, duhet të përmbajnë elaborate për siguri nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

3. Qeveria me akt nënligjor, përcakton llojin e objekteve, masat hapësinore, urbanistike, ndërtimore dhe masat e tjera teknike të mbrojtjes.

**Neni 59**
**Evakuimi**

1. Evakuimi i banorëve të rrezikuar bëhet atëherë kur me masa të tjera nuk mund të garantohet siguria e tyre.

2. Vendimi për evakuim merret nga Qeveria, Kryetari i Komunës ose në raste emergjente nga komandanti i incidentit.

3. Lëvizja e banorëve nga zona e paraparë për evakuim në vendin e caktuar duhet të bëhet sipas mënyrës dhe afateve kohore të përcaktuara në planet e reagimit emergjent apo siç është përcaktuar në vendimin e organit kompetent.

4. Zhvendosja e banorëve në komunitetin tjetër lokal nuk mund të ndikojë në ndryshimin e statusit juridik të tyre.

5. Komuna, në të cilin janë vendosur banorët e evakuuar, e siguron akomodimin, kujdesin dhe edukimin e tyre.

6. Shpenzimet nga paragrafi 5. i këtij neni, Komunës ia kompenson Komuna nga ku ata janë zhvendosur apo shteti.

**Neni 60**
**Akomodimi dhe kujdesi ndaj njerëzve në rrezik**

1. Qeveria dhe komunat janë të obliguar të sigurojnë strehim dhe kujdes të domosdoshëm për qytetarët, të cilët në rast të fatkeqësisë natyrore apo fatkeqësisë tjetër kanë humbur shtëpitë dhe mjetet e tyre të jetës dhe nuk mund të kthehen në vendbanimet e tyre për shkak të rrezikut.

2. Në raste të jashtëzakonshme, kur nuk mund të sigurohet akomodim tjetër, Kryetari i Komunës kërkon nga pronarët ose shfrytëzuesit e ndërtesave të banimit t'i strehojnë përkohësisht banorët e evakuuar të cilët janë të rrezikuar.

**Neni 61**
**Mbrojtja radiologjike, kimike dhe biologjike**

1. Mbrojtja radiologjike, kimike dhe biologjike, përbën masat dhe mjetet për mbrojtje të drejtpërdrejtë nga efektet e armëve nukleare, kimike dhe biologjike, si dhe nga pasojat e incidenteve që përfshijnë materiet e rrezikshme.

2. Pronarët dhe shfrytëzuesit e objekteve dhe të pajisjeve të destinuara për furnizim publik, transport dhe deponim të gjërave ushqimore, medikamenteve, ushqimit për kafshë, shërbimet publike, shëndetësore, ruajtje dhe arsimim të fëmijëve, duhet t'i sigurojnë mjetet mbrojtëse dhe t'i ndërmarrin masat e parapara për mbrojtje kimike, biologjike dhe radiologjike.

3. Qeveria me akt nënligjor rregullon organizimin e mbrojtjes radiologjike, kimike dhe biologjike, si dhe i përcakton mjetet dhe masat për mbrojtje.

**Neni 62**
**Strehimi**

1. Strehimoret dhe objektet tjera për mbrojtje ndërtohen me qëllim të mbrojtjes së njerëzve në raste të luftës apo rreziqeve tjera.

2. Strehimoret ndahen në strehimore të mbrojtjes elementare dhe plotësuese.

3. Strehimoret e mbrojtjes elementare ndërtohen në qytete dhe vendbanime të rrezikuara brenda ndërtesave të reja, të destinuara për shërbime të shëndetit publik, kujdesit dhe edukimit të fëmijëve, mbrojtje të trashëgimisë kulturore, informimit publik, televizioneve dhe radiove kombëtare, trafikut hekurudhor dhe ajror si dhe në ndërtesat e rëndësishme për furnizim me energji dhe ndërtesat industriale të destinuara për tu shfrytëzuar në kohë lufte për mbajtjen e aktiviteteve të rëndësisë së veçantë për mbrojtje dhe siguri.

4. Strehimoret në ndërtesat e reja në vendbanimet e caktuara, pllaka e parë duhet të përforcohet deri në masën që i reziston depërtimit të rrënojave.

5. Strehimoret ndërtohen si objekte të përdorimit të dyfishtë deri në masën që nuk e çrregullon funksionin e tyre mbrojtës.

6. Objektet tjera për mbrojtje duhet të ndërtohen në atë formë që sigurojnë strehim nga rrënojat.

**Neni 63**
**Strehimoret publike**

1. Me qëllim të sigurimit të strehimit për njerëzit në vendet publike duhet të përdoren strehimoret publike apo objektet tjera të përshtatshme.

2. Strehimoret publike janë në kompetencë të autoriteteve lokale.

**Neni 64**
**Funksionet mbrojtëse të strehimoreve**

1. Strehimoret për mbrojtje elementare duhet të sigurojnë mbrojtje nga mbi-presioni, rrënojat, radioaktiviteti, zjarri dhe efektet e armëve dhe materiet tjera kimike si dhe duhet të furnizohen në masën që mundëson banim për një kohë më të gjatë.

2. Strehimoret e mbrojtjes plotësuese duhet të sigurojnë mbrojtje nga rrënojat.

**Neni 65**
**Mirëmbajtja dhe përdorimi i strehimoreve**

1. Pronarët dhe shfrytëzuesit janë të obliguar të mirëmbajnë strehimoret në gjendjen që i përputhen qëllimit.

2. Në raste emergjente, strehimorja duhet të bëhet e gatshme për përdorim brenda njëzetekatër (24) orëve.

3. Ndryshimet që e dobësojnë funksionin mbrojtës të strehimoreve janë të ndaluara pa përjashtim.

**Neni 66**
**Financimi i ndërtimit të strehimoreve**

1. Investitorët janë të obliguar t'i ndërtojnë strehimoret me mjete vetanake financiare.

2. Në rastet e strehimoreve publike investitor është niveli lokal.

3. Me qëllim të përkrahjes së ndërtimit të strehimoreve, shteti mund të ofroj garanci dhe subvencione.

4. Ministria vendos për kërkesat, për marrjen e garancive dhe dhënien e subvencioneve.

5. Qeveria me akt nënligjor përcakton lokacionet dhe hapësirat ku duhet të ndërtohen strehimoret, si dhe kushtet për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

6. Ministria me akt nënligjor përcakton normat teknike për strehimore dhe për adaptimin e objekteve për strehim.

**Neni 67**
**Mbrojtja e trashëgimisë kulturore**

1. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore përfshinë përgatitjet dhe ndërmarrjen e masave për zvogëlimin e rreziqeve, parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit negativ të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera në trashëgiminë kulturore.

2. Përgatitjet dhe masat zbatohen nga pronarët dhe shfrytëzuesit e trashëgimisë kulturore, shërbimi për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, nivelet qendrore dhe lokale.

3. Gjatë realizimit të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, sipas nevojës, marrin pjesë edhe njësitë dhe shërbimet gjegjëse të mbrojtjes dhe shpëtimit, njësitë e zjarrfikjes, si dhe strukturat tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

4. Qeveria me akt nënligjor rregullon mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.

## KREU VII
## MBROJTJA PERSONALE DHE RECIPROKE

**Neni 68**
**Shtrirja dhe përgjegjësitë**

1. Mbrojtja personale dhe reciproke përfshin masat që i ndërmarrin qytetarët për pengimin dhe zvogëlimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera për shëndetin, jetën dhe pronat e tyre.

2. Organizimi, zhvillimi dhe drejtimi i mbrojtjes personale dhe reciproke është në kompetencë të autoritetit lokal, të cilët mund të themelojnë shërbime këshillimi.

3. Qeveria me akt nënligjor përcakton mjetet dhe pajisjet për mbrojtje personale dhe kolektive, të cilat duhet të sigurohen nga qytetarët, pronarët dhe shfrytëzuesit e ndërtesave, ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera, si dhe organet publike, në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.

## KREU VIII
## STRUKTURAT PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE NDIHMË

### Neni 69
### Detyrat dhe organizimi i mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës

1. Mbrojtja, shpëtimi dhe ndihma, në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, përfshin:

1.1. ndihmën për qytetarët e rrezikuar dhe të goditur;

1.2. ndihmën e parë mjekësore;

1.3. ndihmën e parë veterinare;

1.4. shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin nga zjarret;

1.5. shpëtimin nga rrënojat, ortekët, rrëshqitjet;

1.6. shpëtimin nga vërshimet dhe format tjera të shfaqjes së ujit, katastrofat e tjera meteorologjike, fatkeqësitë ekologjike dhe nga fatkeqësitë e tjera nga lumenjtë dhe liqenet;

1.7. shpëtimin në rastet të aksidenteve të mëdha në trafik;

1.8. shpëtimin në raste e incidenteve në miniera;

1.9. shpëtimin në bjeshkë;

1.10. shpëtimin në shpella, humnera, etj;

1.11. shpëtimin në ujë dhe nën ujë;

1.12. shpëtimin në raste të çrregullimeve të papritura;

1.13. mbrojtjen radiologjike, kimike dhe biologjike nga armët nukleare, kimike dhe biologjike, mjetet tjera të shkatërrimit në masë dhe në incidentet që përfshijnë materiet e rrezikshme;

1.14. kërkimin e personave të humbur në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.15. shpëtimin në raste të luftës, sulmeve terroriste dhe formave tjera të dhunës në masë;

1.16. sigurimin e kushteve elementare për jetë.

**Neni 70**
**Zbatimi i detyrave**

1. Detyrat zbatohen nga:

1.1. njësitet, shërbimet dhe strukturat operative të shoqatave dhe organizatave tjera jo qeveritare;

1.2. Organizatat dhe institucionet;

1.3. njësitë dhe ekipet e reagimit emergjent;

1.4. Policia e Kosovës;

1.5. Forca e Sigurisë së Kosovës.

**Neni 71**
**Shoqatat dhe organizatat tjera jo qeveritare**

1. Njësitë, shërbimet dhe strukturat operative të shoqatave dhe organizatave tjera joqeveritare, kryejnë detyrat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës apo të shërbimit publik, në bazë të vendimit të autoritetit të nivelit lokal apo qendror, nëse i përmbushin kushtet e parapara me këtë ligj.

2. Organi kompetent vendos për:

2.1. strukturën, shtrirjen dhe mënyrën e kryerjes së detyrave apo shërbimit publik;

2.2. fillimin e realizimit të detyrave apo shërbimit publik;

2.3. mjetet financiare që i siguron organi përkatës i nivelit lokal apo qendror për kryerjen e detyrave apo shërbimit publik;

2.4. mjetet financiare për pagimin e kontributeve për qytetarët që pësojnë gjatë intervenimit dhe sëmundjes profesionale;

2.5. mbikëqyrjen e kryerjes së detyrave apo shërbimit publik.

3. Shtrirja dhe mënyra e zbatimit të detyrave apo shërbimit publik përcaktohet në përputhje me standardet e zbatueshme për organizimin dhe pajisjet e njësive, shërbimeve dhe strukturave tjera operative të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

4. Kur përcaktohet nga organi kompetent që njësitë, shërbimet dhe strukturat tjera operative të një shoqate apo organizate tjetër jo qeveritare dështojnë në kryerjen e detyrave apo shërbimit publik, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe vendimin e organit kompetent përcaktohet afati kohor për të cilin shoqata apo organizata përkatëse duhet rregulluar gjendjen.

5. Nëse shoqata apo organizata dështon në rregullimin e gjendjes brenda afatit të përcaktuar, duhet të largohet nga zbatimi i detyrave apo shërbimit publik përkatës.

6. Pavarësisht nga dispozitat e këtij neni, shoqatat dhe organizatat tjera jo qeveritare mund të marrin pjesë vullnetarisht në mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, nëse mund të sigurojnë personelin dhe pajisjet e nevojshme

**Neni 72**
**Shërbimet e mbrojtjes publike, shpëtimit dhe ndihmës**

1. Shërbimet e mbrojtjes publike, shpëtimit dhe ndihmës përfshijnë:

1.1. shërbimin e zjarrfikës që sigurohet nga njësitë e zjarrfikëseve në përputhje me Ligjin për zjarrëfikje dhe shpëtim;

1.2. shërbimin e shpëtimit bjeshkatar të siguruar nga stacionet e shpëtimit bjeshkatar në përputhje me standardet për organizim dhe pajisje të njësive, shërbimeve dhe strukturave operative për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;

1.3. shërbimin e shpëtimit në shpella dhe humnera të siguruar nga shpellarët-shpëtimtar të organizuar në klube të shpellarëve në përputhshmëri me vendimet e organit përgjegjës qendror;

1.4. shërbimet e shpëtimit në ujë të siguruar nga zhytësit në përputhje me standardet për organizim dhe pajisje të njësive, shërbimeve dhe strukturave tjera operative të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;

1.5. shërbimin për mbrojtje dhe shpëtim në rast të fatkeqësive ekologjike dhe fatkeqësive tjera të organizuara nga niveli lokal dhe qendror.

2. Shërbimi i Hetimeve Unike për grumbullimin, komunikimin dhe incizimin e të dhënave për qytetarët e goditur në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera, përfshirë gjendjen e luftës dhe atë emergjente, duhet të organizohen dhe trajtohen nga Kryqi i Kuq i Republikës së Kosovës.

3. Kryqi i Kuq i Republikës së Kosovës do të kujdeset për kurset e trajnimit për ndihmën e parë dhe të zbatoj fuqi tjera publike në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe do të zbatoj detyrat në përputhshmëri me standardet për organizimin dhe pajisjen e njësive, shërbimeve dhe strukturave tjera operative për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

**Neni 73**
**Ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera**

1. Me qëllim të zbatimit të detyrave specifike operative të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, organi përgjegjës qendror apo lokal mund të angazhoj ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera, nëse ato janë në gjendje të sigurojnë personelin dhe pajisjet e nevojshme.

2. Ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera me qëllim të zbatimit të detyrave nga paragrafi 1. i këtij neni, duhet të sigurojnë trajnime për punëtorët e tyre dhe të përgatiten për veprim në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.

3. Organi përgjegjës qendror ose lokal do të kompensoj ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera të angazhuara për zbatimin e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës për koston e efektive të dalë nga pjesëmarrja në zbatimin e detyrave dhe përgatitjeve të cilat nuk janë në aktivitetet e tyre të zakonshme.

4. Qeveria në standardet e saj për organizimin dhe pajisjen e njësive, shërbimeve dhe strukturave tjera operative të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës duhet të përfshijë edhe standardet për angazhimin e ndërmarrjeve, institucioneve dhe organizatave tjera të cilat kanë pajisje specifike apo kapacitete tjera ose janë të përfshira në aktivitete të rëndësishme për zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

5. Ministria - Agjencia apo institucionet tjera përgjegjëse qendrore apo lokale për llojin e fatkeqësisë, duhet të nënshkruajnë marrëveshje me ndërmarrje, institucione dhe organizata tjera, ku përcaktohen pjesëmarrja dhe obligimet e tyre sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 3. të këtij neni.

6. Në pajtueshmëri me standardet e zbatueshme për organizimin, pajisjen dhe trajnimin e njësive, shërbimeve dhe strukturave tjera operative të shoqatave dhe organizatave jo qeveritare, Agjencia dhe organi përkatës lokal duhet të nënshkruajnë marrëveshje sipas paragrafit 5. të këtij neni edhe me shoqatat dhe organizatat jo qeveritare që organizojnë njësitë, shërbimet dhe strukturat tjera operative të tilla.

7. Marrëveshjet nga paragrafi 5. dhe 6. të këtij neni, përveç tjerash duhet të përcaktojnë në veçanti llojin dhe madhësinë e njësisë, shërbimit dhe strukturës tjetër operative, zbatimin e shërbimeve publike sipas këtij ligji, përgjegjësinë për arritjen dhe mbajtjen e gatishmërisë dhe obligimeve tjera shtetërore të lidhura me pjesëmarrjen e tyre në mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

8. Me qëllim të mbajtjes së nivelit të caktuar te gatishmërisë, të nevojshme për zbatimin e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat vullnetare, shoqatat dhe organizatat tjera jo qeveritare, bazuar në paragrafin 5. dhe 6. të këtij neni, mund të pajisen pa pagesë me pajisje dhe pajime të mbrojtjes dhe shpëtimit, për të cilat ata obligohen t'i mirëmbajnë. Pajisjet dhe pajimet e tilla mund të largohen vetëm për qëllime të zëvendësimit me pajisje të reja si dhe ne raste te ndërprerjes se marrëveshje.

**Neni 74**
**Njësitë dhe shërbimet e mbrojtjes dhe shpëtimit**

1. Nëse detyrat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës nuk mund të kryhen nga shërbimet profesionale të shpëtimit, njësitë dhe shërbimet e mbrojtjes dhe shpëtimit organizohen si më poshtë:

1.1. njësitë teknike të shpëtimit;

1.2. njësitë për ndihmë të parë veterinare;

1.3. njësitë dhe shërbimet për mbrojtje radiologjike, kimike dhe biologjike;

1.4. shërbimet për shfrytëzimin e strehimoreve;

1.5. qendrat e logjistikës dhe të informimit;

1.6. shërbimet e mbështetjes dhe

1.7. njësitë dhe shërbimet tjera bazuar në vlerësimin e rreziqeve.

2. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, organizohen komisione të përhershme dhe të përkohshme të ekspertëve për vlerësimin e dëmeve në ndërtesa si dhe për detyra tjera të posaçme, në përputhje me planet e reagimit emergjent dhe vlerësimin e rreziqeve për zbatimin e detyrave të caktuara të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

3. Qeveria me akt nënligjor përcakton njësitë dhe shërbimet nga paragrafi 1. i këtij neni të cilat duhet të organizohen nga niveli qendror dhe lokal, ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera në përputhje me standardet e aplikueshme për organizimin, pajisjen dhe trajnimin e SMSHN.

**Neni 75**
**Mbrojtja nga mjetet e pa shpërthyera**

1. Mbrojtja nga mjetet e pa shpërthyera  përmban - zbulimin, sigurimin, largimin, transportin dhe shkatërrimin e tyre.

2. Për zbatimin e detyrave nga paragrafi 1. i këtij neni vlejnë dispozitat e ligjit për themelimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

**Neni 76**
**Ruajtja e rendit dhe qetësisë publike**

Në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera Policia e Kosovës është përgjegjëse për të siguruar qetësi dhe rend publik në zonat e kërcënuara dhe të goditura.

**Neni 77**
**Mobilizimi dhe aktivizimi**

1. Vendimin për mobilizimin e SMSHN, organizatave dhe shërbimeve tjera emergjente  e nxjerrin organet përkatëse si pas nivelit.

2. Vendimi për aktivizimin e SMSHN dhe shërbimeve tjera emergjente në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera merret në raport me dispozitat e përcaktuara në Planin e Reagimit Kombëtar sipas niveleve përkatëse.

**Neni 78**
**Menaxhimi i strukturave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës**

1. Menaxhimi operativ dhe taktik i SMSHN  organizohet dhe zbatohet sipas parimeve të Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Emergjencave dhe në harmoni me Planin e Reagimit Kombëtar

2. Menaxhimi duhet të bazohet në zbatimin e detyrueshëm të vendimeve të marra nga autoritetet përgjegjëse për menaxhimin e njësive për mbrojtje dhe shpëtim, si dhe shërbimeve tjera të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

3. Çdo komandant apo udhëheqës duhet të caktoj zëvendës. Në mungesë të zëvendësit, ai duhet të caktoj personin tjetër që ta zëvendësoj atë.

4. Çdo komandant apo udhëheqës duhet t'i njohë eprorët dhe vartësit e tij.

5. Asnjë personi nuk duhet t'i kërkohet apo lejohet zbatimi i vendimit, kur rasti në të cilin bëhet një gjë e tillë, kryhet krim apo veprim në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar humanitar.

**Neni 79**
**Menaxhimi i njësive, shërbimeve dhe strukturave tjera operative**

1. Njësitë, shërbimet dhe strukturat tjera operative të organizuara në shoqata dhe organizata tjera jo qeveritare, të cilat marrin pjesë në mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, menaxhohen në mënyrë të pavarur nga udhëheqësit e tyre në përputhje me dispozitat teknike dhe ligjore.

2. Kur mbrojtja, shpëtimi dhe ndihma realizohet nga më shumë se një njësi, shërbim apo strukturë operative tjetër,  të gjithë duhet vepruar në përputhje me vendimet e marra nga Komandanti i Incidentit te caktuar.

**Neni 80**
**Pjesëmarrja e forcave të sigurisë dhe atyre policore**

1. Nëse forcat e sigurisë marrin pjesë në mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë menaxhimin e tyre e bëjnë eprorët e tyre në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Komandanti i Incidentit.

2. Policia, organizimin dhe zbatimin e detyrave në mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë duhet t'i kryej në përputhje me rregullat dhe udhëzimet e dhëna nga Komandanti i Incidentit.

**Neni 81**
**Detyrat e komandantit të Incidentit**

1. Komandanti i Incidentit do të:

   1.1. verifikon gatishmërinë për intervenim të njësive emergjente dhe resurseve tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;

   1.2. udhëheq mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën në rast të fatkeqësive;

   1.3. siguroj ndërlidhje dhe veprim të koordinuar për të gjitha SMSHN;

   1.4. bëj propozime lidhur me përgatitjen e SMSHN si dhe për rimëkëmbje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

   1.5. kërkoj aktivizimin e Qendrave Operative Emergjente.

2. Komandanti i Incidentit mund të caktoj përgjegjës për të menaxhuar intervenimet individuale të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

**Neni 82**
**Kompetencat e veçanta**

1. Në drejtimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, Komandanti i Incidentit ka të drejtë dhe detyrë të ndaloj qasjen e personave të paautorizuar në zonat e goditura dhe të urdhëroj që:

   1.1. njerëzit, kafshët dhe të mirat materiale të zhvendosen nga ndërtesat dhe zonat e goditura;

   1.2. të lejohet qasja në strehimore;

   1.3. të mundësohet përdorimi apo vendosja e mjeteve të veçanta të komunikimit;

   1.4. të bëhet largimi i pengesave që pengojnë intervenimin e suksesshëm;

   1.5. të vihen në dispozicion për përdorim mjetet private të transportit për bartjen e të lënduarve apo mjeteve të nevojshme për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;

   1.6. qytetarët e përgatitur të marrin pjesë në aktivitetet e shpëtimit në përputhje me aftësitë dhe resurset e tyre të përshtatshme për shpëtim;

   1.7. pronat private të përdoren për qëllime të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;

   1.8. pronat të përdoren si depo të përkohshme për rrënoja, pjesë dhe materiale tjera të dala gjatë kryerjes së detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës të destinuara për sigurimin e kushteve elementare për jetë;

1.9. shkatërrimin e ndërtesave apo prerjen e pemëve.

2. Masat e përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, mund të urdhërohen vetëm atëherë kur asnjë masë tjetër nuk mund të siguroj mbrojtje të njerëzve dhe pronave si dhe zbatim të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës dhe duhet të aplikohen jo më shumë se sa është plotësisht e domosdoshme.

3. Zhvendosja e njerëzve nga paragrafi 1. i këtij neni duhet të urdhërohet nëse jeta e tyre gjendet para rrezikut të pashmangshëm për shkak të zjarrit, eksplodimit apo rrezikut tjetër për kohëzgjatjen e rrezikut të tillë. Policia e Kosovës duhet të ndihmoj zhvendosjen.

4. Gjatë mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës Komandanti i Incidentit ka të drejtë t'i urdhëroj institucionet dhe organizatat tjera nënshkruese të kontratave, organet kompetente qendrore apo lokale, për zbatimin e detyrave të veçanta sipas këtij ligji, punë urgjente ndërtimore, teknike dhe të tjera.

5. Nëse detyrat duhet të kryhen me qëllim të shpëtimit dhe mbrojtjes së njerëzve, pronave, kafshëve apo mjedisit apo për mbrapsjen e rrezikut të pashmangshëm, komandanti i incidentit ka të drejt që të urdhëroj që këto detyra të kryhen nga personat fizik dhe juridik të cilët kanë kapacitet apo pajisje adekuate. Urdhri duhet të jetë me shkrim apo në situatat e papritura edhe me gojë dhe duhet të precizoj llojin dhe shtrirjen e punës që duhet kryer.

6. Për urdhëratë e dhëna nga Komandanti i Incidentit duhet të mbahen shënime. Për vendimet me implikime të mëdha financiare duhet të lëshohen urdhra me shkrim. Kur e lejojnë rrethanat duhet të lëshohen urdhra me shkrim sa më shpejt që të jetë e mundur. Në rastet urgjente Komandanti i Incidentit duhet të ketë të drejt që të urdhëroj pronarët privat të objekteve të banimit apo objekteve tjera, të ofrojnë strehim dhe kujdes të përkohshëm për personat e kërcënuar derisa të merret vendimi nga Kryetari i Komunës apo Qeveria.

7. Nëse operacionet e mbrojtjes dhe shpëtimit drejtohen nga autoritetet përgjegjëse regjionale apo qendrore, vendimi për mbulimin e shpenzimeve të punëve urgjente të menaxhuara nga autoritetet e komunitetit lokal duhet të bëhet nga Kryetari i Komunës.

**Neni 83**
**Ndihma**

1. Kur, në rast të fatkeqësisë natyrore apo fatkeqësisë tjetër, kërkohet ndihma e komunitetit fqinjë lokal në kuptimin e strukturave dhe resurseve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, Komandanti i Incidentit mund ta kërkojnë këtë ndihmë, në koordinim me Kryetarin e Komunës.

2. Përveç ndihmës së siguruar nga marrëveshjet bilaterale, Komandanti i Incidentit mund të kërkojnë ndihmë nga një komunitet lokal i afërt në shtetin fqinjë.

3. Përveç ndihmës së siguruar nga marrëveshjet bilaterale, kërkesa për ndihmë nga vendet tjera në aspektin e forcave dhe resurseve në rastin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera bëhet nga Qeveria.

4. Komunitetet lokale në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera mund të ofrojnë ndihmë në komunitetin lokal të vendit tjetër të siguruar nga një marrëveshje ndërshtetërore.

**Neni 84**
**Zbatimi i mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në vendet tjera**

1. Ndihma për vendet tjera në zbatimin e mbrojtjes dhe shpëtimit në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe përmbushja i obligimeve ndërkombëtare të shtetit duhet të kryhet nga

njësitë, shërbimet dhe strukturat operative të caktuara për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, të cilat organizohen në nivel qendror sipas këtij ligji.

2. Njësitë, shërbimet apo strukturat operative të dislokuara në vendet tjera për kryerjen e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës me qëllim të përmbushjes së obligimeve ndërkombëtare të shtetit duhet të udhëhiqen nga komandantët apo udhëheqësit e tyre dhe në përputhje me vendimet e marra nga autoritetet qendrore apo autoritetet e organizmave ndërkombëtar në të cilat zhvillohen operacionet. Në raste të pasigurisë, duhet të vendos komandanti apo udhëheqësi, në përputhje me udhëzimet e siguruara nga një organ përkatës i Republikës se Kosovës.

3. Të gjithë pjesëtarët e njësive, shërbimeve dhe strukturave operative të dislokuar jashtë vendit për trajnime, ushtrime, ofrimin e ndihmës në rast të fatkeqësisë apo për të përmbush obligimet ndërkombëtare të shtetit janë të obliguar të kenë sigurim jetësor në rast të vdekjes, humbjes së përhershme dhe të përkohshme të aftësive të tyre për punë.

4. Bazuar në vendimet e marra nga organi përkatës dhe në përputhje me planet e reagimit emergjent çdo njësi, shërbim apo strukturë operative mund të dislokohet në rajonet kufitare për të ofruar ndihmë në zonat kufitare të vendeve tjera.

**Neni 85**
**Përgjegjësi për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë**

1. Përgjegjësi për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë duhet të caktohet në ndërtesat e banimit, institucionet dhe organizata tjera në përputhje me rreziqet në zonat e banuara.

2. Përgjegjësi i mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës duhet të drejtoj zbatimin e mbrojtjes personale dhe reciproke të banorëve të organizoj dhe koordinoj zbatimin e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës brenda zonës së tyre.

**Neni 86**
**Simbolet**

1. Simbolet e pjesëtarëve të angazhuar në SMSHN përfshinë :

   1.1. simbolin që dëshmon anëtarësinë;

   1.2. simbolin që dëshmon pozitën;

   1.3. simbolin që dëshmon fushëveprimin përkatës.

2. Ndalohet riprodhimi, apo përdorimi i paautorizuar i Simboleve dhe uniformës dhe çdo riprodhim i Simboleve të mjeteve të qarkullimit të njësive dhe shërbimeve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

3. Simboli përcaktohet me akt nënligjor nga Qeveria.

4. Me akt nënligjor Ministria përcakton llojin, formën dhe modelin e uniformës për SMSHN.

**Neni 87**
**Shpërblimet dhe mirënjohjet**

1. Për rezultatet e dalluara në fushën e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, jepen mirënjohje dhe shpërblime për:

1.1. kontribut në parandalimin e rreziqeve;

1.2. kontribut në zbatimin e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;

1.3. veprime të guximshme;

1.4. shpikje dhe inovacione;

1.5. arritje në zhvillim dhe hulumtim;

1.6. arritje në trajnime dhe aftësim;

1.7. veprën jetësore në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

2. Mirënjohjet dhe shpërblimet, nga paragrafi 1. e këtij neni përcaktohen me Akt nënligjor, nga Qeveria me propozimin e Ministrisë.

**Neni 88**
**Kuvendi i Republikës së Kosovës**

1. Në kuptim të këtij ligji Kuvendi kryen detyrat si më poshtë:

1.1. përcakton kahjet themelore të organizimit dhe zbatimit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.2. miraton programin kombëtar për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, të propozuar nga Qeveria;

1.3. mbikëqyr zbatimin e planit kombëtar dhe zbatimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.4. me propozimin e Qeverisë, merr vendime lidhur me furnizimin me resurse dhe çështje tjera të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë e mëdha natyrore.

**Neni 89**
**Qeveria e Republikës së Kosovës**

1. Qeveria kryen detyrat si më poshtë:

1.1. drejton dhe koordinon organizimin, përgatitjen dhe zbatimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në vend;

1.2. miraton planin vjetor për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.3. miraton planet kombëtare të reagimit emergjent;

1.4. menaxhon mbrojtjen, shpëtimin, ndihmën dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë e mëdha natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.5. aranzhon ndihmën ndërkombëtare në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.6. propozon kuvendit miratimin e programin kombëtar për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

**Neni 90**
**Komisionet për vlerësimin e dëmeve**

1. Vlerësimi i dëmeve në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera dhe përgatitja e propozimeve për rimëkëmbje nga fatkeqësitë e tilla, bëhet nga komisionet në nivel qendror dhe lokal.

2. Anëtarët e komisioneve nga paragrafi 1. të këtij neni, caktohen në cilësinë e ekspertëve, përfaqësuesit e administratës publike, komunitetet lokale, shërbimet publike, organizatat dhe kompanitë e sigurimeve.

3. Nga palët e dëmtuara kërkohet që të grumbullojnë prova lidhur me dëmet e pësuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera me shpenzime të tyre dhe t'i dorëzojnë tek komisioni përkatës për vlerësim dhe miratim.

4. Me propozim të Ministrisë, Qeveria me akt nënligjor përcakton përbërjen e komisioneve dhe metodologjinë e vlerësimit të dëmeve materiale dhe pasojave tjera të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

**Neni 91**
**Detyrat e Kryetarit të Komunës**

1. Kryetari i Komunës kryen detyrat si më poshtë:

1.1. kujdeset për realizimin e përgatitjeve për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.2. miraton planet e reagimit emergjent në nivel komunal;

1.3. përcakton llojin dhe madhësinë e SMSHN ;

1.4. kujdeset për implementimin e masave për parandalimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera;

1.5. menaxhon mbrojtjen, shpëtimin ndihmën dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.6. kujdeset për njoftimin e banorëve për rrezikun, gjendjen e mbrojtjes dhe masat e ndërmarra për mbrojtje;

1.7. cakton Komandantin e Incidentit me rekomandimin e Menaxherit Emergjent.

**Neni 92**
**Menaxhmenti**

1. Menaxhmenti i ndërmarrjeve, institucioneve dhe organizatave tjera ka për detyrë të:

1.1. kujdeset për implementimin e përgatitjeve për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

1.2. menaxhon mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.

2. Me qëllim të menaxhimit operativ dhe teknik të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, menaxhmenti cakton Komandantin e Incidentit, apo menaxherin dhe miraton planet e reagimit emergjent.

3. Komandanti i Incidentit dhe strukturat e përcaktuara në paragrafin 2. të këtij neni caktohen nga përfaqësues të ndërmarrjeve, institucioneve dhe organizatave tjera dhe nga institucionet të cilat ofrojnë trajtim mjekësor të rëndësisë regjionale.

## KREU IX
## ADMINISTRIMI

### Neni 93
### Detyrat e Ministrive

1. Qeveria i drejton dhe koordinon aktivitetet e Ministrive në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

2. Ministritë përkatëse janë përgjegjëse për zbatimin e masave për parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, respektivisht zvogëlimin e pasojave brenda kompetencave të tyre.

3. Ministritë përkatëse janë përgjegjëse për gjendjen e gatishmërisë për kryerjen e aktiviteteve brenda kompetencave të tyre në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.

4. Detyrat dhe përgjegjësit e institucioneve qendrore dhe strukturave te reagimit emergjent përcaktohen ne Planin e Reagimit Kombëtar.

### Neni 94
### Agjencia e Menaxhimit Emergjent dhe detyrat e saj

1. Agjencia e Menaxhimit Emergjent vepron si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe i përgjigjet drejtpërsëdrejti Ministritë.

2. Agjencia udhëhiqet nga Kryeshefi në pajtueshmëri me rregullat në fuqi për emërimin e nëpunësve të lartë në shërbimin civil.

3. Struktura organizative e Agjencisë rregullohet ma akt nënligjor të miratuar nga Qeveria.

4. Agjencia kryen detyra menaxheriale dhe teknike të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, veçanërisht në:

4.1. elaborimin e propozimeve për projekte zhvillimore dhe kërkimore;

4.2. elaborimin e propozimit për programin dhe planin kombëtar;

4.3. kujdeset për organizimin dhe funksionimin e sistemit të monitorimit, lajmërimit dhe alarmimit,

4.4. planifikimin, ngritjen, funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemit unik të komunikimit, informimit dhe përcaktimit të kushteve teknike për integrimin e sistemeve tjera;

4.5. elaborimin e vlerësimit të rreziqeve dhe dokumenteve teknike për planifikimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës si dhe drejtimin dhe koordinimin e masave për parandalim dhe lehtësimin e pasojave;

4.6. monitorimin dhe lajmërimin e rrezikut dhe dhënia e udhëzimeve për përballje me to;

4.7. hartimin e draft planeve kombëtare të reagimi emergjent në bashkëpunim me ministritë dhe agjencitë qeveritare;

4.8. organizimin, pajisjen dhe trajnimin e strukturave qendrore të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës dhe strukturave tjera të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës si dhe krijimin e kushteve për funksionimin e strukturave organizative të Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Emergjencave;

4.9. mbikëqyrjen dhe koordinimin e organizimit të SMSHN dhe shërbimeve tjera.

4.10. përgatitjen e plan programeve, organizimin dhe realizimin e trajnimeve dhe aftësimit në fushën e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;

4.11. klasifikimin e resurseve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë dhe

4.12. krijimin dhe mirëmbajtjen e rezervave materiale kombëtare për raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.

5. Agjencia është përgjegjës për zhvillimin e koordinuar të SMSHN në vend, në përputhshmëri me vlerësimin e rreziqeve dhe planeve të reagimit emergjent dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria.

6. Në fushën e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës Agjencia ka të drejtë që në bazë të vendimeve të marra nga Qeveria apo në bazë të kërkesës së komandantit të incidentit të siguroj për popullatën e goditur resurse ndihmash apo pajisje dhe mjete specifike të mbrojtjes dhe shpëtimit të domosdoshme për veprimin e strukturave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës dhe shërbimeve tjera emergjente.

7. Ndihma në resurse, pajisje dhe mjete të mbrojtjes mund të jetë pa pagesë dhe e bazuar në një marrëveshje përkatëse.

8. Ndihma e tillë, në mënyrë të veçantë, mund të jepet për të siguruar nivelin e duhur të gatishmërisë për zbatimin e detyrave të caktuara të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në përputhje me standardet e përcaktuara nga Ministria.

## KREU X
## MBIKËQYRJA

### Neni 95
### Zyra e Inspektorit Kryesor

1. Monitorimi i zbatimit të këtij Ligji, në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera mbikëqyret nga Zyra e Inspektorit Kryesor të Agjencisë.

2. Inspektori Kryesor gjatë zhvillimit të inspektimit mbikëqyrë:

2.1. zbatimin e masave për parandalimin dhe lehtësimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

2.2. gjendjen e planeve dhe përgatitjeve të tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;

2.3. zbatimin e detyrave të monitorimit, lajmërimit dhe paralajmërimit;

2.4. aftësitë, pajisjet dhe gatishmërinë e SMSHN dhe shërbimeve tjera emergjente.

2.5. mënyrën e trajtimit të çështjeve administrative dhe teknike në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

3. Ministria me akt nënligjor përcakton mënyrën e mbikëqyrjes nga Inspektori Kryesor në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

## KREU XI
## PUNA PROFESIONALE, SHËNDETI DHE SIGURIA NË PUNË

### Neni 96
### Kushtet e veçanta të punës

1. Për punëtorët për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera, vlejnë dispozita për shërbyesit civil të legjislacionit në fuqi, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

2. Në përputhshmëri me rregullat e përgjithshme, nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit në detyra të caktuara të përshkruara në sistematizim janë të obliguar të punojnë sipas kërkesave të shërbimit në kushte të veçanta, përfshirë punën gjatë natës, vikendeve, festave, ditëve të lira, detyrave të rregullta apo të përkohshme, punën në terren apo punën sipas orarit jo të rregullt.

3. Për shkak të kërkesave të shërbimit, nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit janë të obliguar të punojnë në bazë të vendimit të mbikëqyrësit të tyre në kushte të posaçme të punës sipas orarit jo të rregullt dhe nën kushte jo të rregullta të punës, përfshirë rreziqet dhe ngarkesat e veçanta në punë.

4. Puna jashtë orarit, angazhimi, detyra në gatishmëri apo puna në një vend tjetër specifik duhet të urdhërohet, përveç në rastet e përcaktuara me rregullat e përgjithshme, edhe për shkak të kërkesave të shërbimit në vijim:

4.1. kërcënimi i drejtpërdrejt nga fatkeqësia natyrore apo fatkeqësia tjetër apo kërcënimi i shpallur nga lëndët djegëse;

4.2. rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera që kërkojnë përforcime në trupa menaxhues, shërbime, njësi dhe struktura operative që kryejnë operacione të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës apo kur operacionet e tilla duhet të vazhdojnë më tutje;

4.3. rrethanat në të cilat është ofruar ndihma në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera në komunitetet apo vendet tjera apo edhe në organizatat ndërkombëtare bazuar në vendimet e autoriteteve;

4.4. në situatat pas ndodhjes së fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera në të mirë të furnizimit me kushtet elementare për jetë në zonat e goditura, përfshirë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia;

4.5. një kërcënim i shtuar nga sulmi në vend, kërcënimi i drejtpërdrejt nga lufta, gjendja emergjente, shtimi i nivelit të gatishmërisë për shkak të situatave krize apo nëse situata e ndryshuar e sigurisë paraqet rrezik ndaj njerëzve, të mirave materiale, kafshëve, trashëgimisë kulturore apo mjedisit në shkallë të gjerë;

4.6. vazhdimi i punës në mungesë apo humbje të punëtorëve, për të siguruar funksionim të papenguar të qendrave emergjente të paralajmërimit dhe shërbimeve të kujdestarisë

në kapacitetin e domosdoshëm, për zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës si dhe mbështetjen e shërbimeve të lartpërmendura.

5. Puna jashtë orarit urdhërohet me shkrim. Nëse kjo nuk është e mundur për shkak të urgjencës së mbrojtjes dhe shpëtimit duhet të urdhërohet verbalisht. Në raste të tilla urdhri me shkrim duhet t'i dorëzohet shërbyesit civil jo më vonë se fundi i javës nga java në të cilën është dhënë urdhri. Puna jashtë orarit mund të zgjasë deri në gjashtë (6) orë për ditë, njëzet (20) orë për javë, tetëdhjetë (80) orë për muaj dhe njëqindetetëdhjetë (180) orë për vit. Afatet kohore duhet të përcaktohen duke u bazuar në mesataren gjashtëmujore.

6. Nëpunësve civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit, duhet tu jepet e drejta në përfitimin e shtesave të veçanta për punën në kushte të posaçme në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi.

7. Nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit, të caktuar nga mbikëqyrësit e tyre, si dhe ata të cilët kryejnë detyra operative, janë të obliguar të bartin me vete pajisjet teknike në mënyrë që të jenë të informuar për rrezikun apo ndodhin e fatkeqësisë, përveç gjatë pushimeve vjetore apo kur janë jashtë vendit.

8. Nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit të caktuar në detyra operative të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, janë të obliguar të jenë të siguruar për raste të humbjes së jetës, humbjeve të përhershme apo të përkohshme të aftësive të përgjithshme të punës që ndodhin në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, si dhe gjatë ushtrimeve, arsimimit apo trajnimeve.

9. Pjesëtarët e SMSHN-së dhe qytetarët që marrin pjesë vullnetarisht në detyrat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës sipas këtij ligji, kërkohet gjithashtu të kenë sigurim të veçantë.

10. Të drejtë në sigurim afatgjatë apo në sigurim të detyrueshëm pensional, kanë shërbyesit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit të caktuar në detyra operative të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Neni 97**
**Kompensimi për punë ne kushtet e veçanta**

1. Nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera te cilët janë të obliguar te punojnë në kushte te veçanta përveç kompensimit te përcaktuar ne ligjin për pagat e nëpunësve civil do te përfitojnë si ne vijim.

1.1. njëzet përqind (20%), kur kryejnë detyra organizative, menaxhuese, inspektuese apo operative;

1.2. pesëmbëdhjetë përqind (15%), kur kryejnë detyra profesionale dhe teknike të lidhura me zbulimin, sigurimin, zhvendosjen dhe shkatërrimin e mjeteve eksploduese;

1.3. dhjetë përqind (10%), kur kryejnë detyra teknike, analitike, mbikëqyrëse dhe detyra tjera operative;

1.4. pesë përqind (5%), kur kryejnë detyra teknike dhe fizike ndihmëse.

2. Përqindja e përfitimit nga paragrafit 1. i këtij neni përcaktohet në raport me shtrirjen, llojin dhe natyrën e punës së kryer në kushte të posaçme dhe jashtë përgjegjësisë.

**Neni 98**
**Puna në ndërrime të ndara dhe orët e ndryshuara të punës**

1. Ngarkesa ditore e punës së nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit nuk duhet t'i kaloj dymbëdhjetë (12) orë në ditë. Mesatarja e ngarkesës ditore të punës së punëtorëve duhet të llogaritet si mesatare e ngarkesës së punës për periudhën e cila nuk duhet kaluar gjashtë muaj.

2. Puna me ndërrime përfshinë të punuarit në rotacion ku punëtorët punojnë sipas orarit dymbëdhjetë (12) orësh, të përcjellur me njëzetekatër (24) apo dyzetetetë (48) orë pushim dhe të punuarit sipas orarit të posaçëm në mëngjes, pasdite por jo sipas radhës. Nëse puna kryhet në ndërrime apo në rotacion, duhet të sigurohet ndryshimi periodik i ndërrimeve.

3. Nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit të cilët punojnë me ndërrime duhet tu jepet pushimi minimal ditor dhe javor i përcaktuar në afatin i cili nuk i kalon gjashtë (6) muaj.

4. Nëse shërbyesi civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit detyrohet të punoj gjatë ditëve të lira për shkak të kërkesave të shërbimit, atij duhet t'i jepet pushimi javor në muajin aktual apo më së voni në muajin pasues.

5. Puna në ndërrime mund të urdhërohet bazuar në vendimin e mbikëqyrësit për shkak të kërkesave të shërbimit sipas paragrafit 4. të nenit 101 të këtij ligji, masa e përkohshme për të siguruar kushtet elementare për jetë në zonën e goditur apo derisa nuk është më e nevojshme puna në ndërrime.

6. Nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit të cilët punojnë në ndërrime apo në rrotacion duhet të kenë të drejt në pagesë të mjeteve ekzistenciale, nëse është e pamundur të sigurohen shujta gjatë kohës së rregullt të punës. Pagesa ekzistenciale për punën gjatë natës duhet të jetë tridhjetë përqind (30%) më e lartë.

**Neni 99**
**Puna përtej ngarkesës së përcaktuar**

Nëse puna e nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit tejkalon normën e përcaktuar mujore apo javore, diferenca duhet të llogaritet si punë jashtë orarit e cila nuk duhet t'i kaloj njëzet (20) orë për javë apo tetëdhjetë (80) orë për muaj, nëse nuk është e mundur të ndryshohet orari i punës sipas dispozitave të këtij ligji.

**Neni 100**
**Shërbimi i kujdestarisë dhe kushtet tjera të posaçme të punës**

1. Nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit duhet të kryejnë shërbim kujdestarie si mënyrë e rregullt apo të veçantë në vendin e punës apo në ndonjë vend tjetër të paracaktuar.

2. Qëndrimi në thirrje në shtëpi nuk duhet të llogaritet në obligim normativ javor apo mujor. Nëse nëpunësi civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit kryen punë gjatë kohës në thirrje, ato orë duhet të llogariten si punë jashtë orarit.

3. Bazuar në vendimin e mbikëqyrësit i cili është marrë nga ai vetë apo me kërkesën e komandantit të incidentit, nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit duhet të vazhdojnë punën nëse fatkeqësia natyrore apo fatkeqësia tjetër ndodh gjatë orarit të rregullt të punës dhe operacionet e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës nuk kanë përfunduar gjatë orarit të rregullt të punës. Kjo punë duhet të konsiderohet si punë jashtë orarit.

**Neni 101**
**Puna në kushte të papërshtatshme**

1. Nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit janë të detyruar të punojnë në kushte të papërshtatshme ku përfshihen zhurma, dridhjet, zonat e ndotura, aerosole, gazrat, substancat e rrezikshme kimike,mjete eksploduese dhe eksplozive dhe substancat tjera të rrezikshme, nëse

janë të trajnuar për zbatimin e detyrave në kushte të tilla dhe të pajisur me pajisje mbrojtëse personale.

2. Nëse nëpunësi civil nuk posedon pajisjet mbrojtëse personale të nevojshme, ka të ketë të drejtë ta refuzoj detyrën e tillë dhe menjëherë ta informoj eprorin tjetër më të lartë.

3. Nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit të cilët kanë mbet të paaftë për shkak të lëndimeve të pësuara në punë, apo sëmundje profesionale apo në zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, do të ricaktohen në vende tjera të punës te organit përkatës në raport me aftësitë e mbetura për punë apo u jepet e drejta për rehabilitim profesional.

4. E drejta për ricaktim në detyrë në organet lokale apo rehabilitimit profesional vlen edhe për nëpunësit civil të nivelit lokal në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit. Nëse ricaktimi është i pamundur apo nëse rehabilitimi profesional nuk mund të llogaritet i përshtatshëm, atëherë në rrethana të tilla aplikohet legjislacioni në fuqi.

**Neni 102**
**Ditët e lira shtesë dhe kohëzgjatja e kompensimit nga shërbimi**

1. Me qëllim të mirëmbajtjes së gjendjes psikofizike të nëpunësve civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit i caktuar në detyra operative të zhytjes apo të mbrojtjes nga ngjarjet e papritura, ju jepet pesëmbëdhjetë (15) ditë të lira shtesë të pushimit të rregullt vjetor.

2. Nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit që janë të caktuar në detyra operative të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në përputhje me sistematizimin e tyre për më shumë se dhjetë vite kanë të drejtë që për çdo vit shërbimi të përfitojnë pesë përqind (5%) të pagës bazë në shërbim.

3. Ministria me akt nënligjor përcakton mënyrën dhe rrethanat në të cilat mund të përdoren këto ditë të lira.

**Neni 103**
**Ndihma juridike**

1. Nëpunësit civil në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit të cilët janë subjekt i shkeljeve si pasoj e veprimeve të tyre në kryerjen e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës kanë të drejt në ndihmë juridike pa pagesë të siguruar nga organet qendrore apo lokale.

2. Ndihma juridike duhet t'i sigurohet nëpunësve civil nga një organ, nëse vlerësohet se ata kanë vepruar në përputhshmëri me rregullat dhe standardet profesionale të cilat vlejnë për zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

3. E drejta në ndihmë juridike pa pagesë duhet të vlej edhe për qytetarët e angazhuar në strukturat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, për kohëzgjatjen e angazhimit.

**Neni 104**
**Shëndeti dhe siguria në punë**

1. Për zbatimin e detyrave në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera duhet të aplikohen dispozitat e legjislacionit që rregullojnë çështjet e shëndetit dhe sigurisë në punë, nëse me këtë Ligj nuk parashihet ndryshe.

2. Ministria me akt nënligjor përcakton masat dhe procedurat për sigurimin e shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve, pjesëtarëve të SMSHN, si dhe pjesëtarëve të njësive, shërbimeve dhe strukturave operative brenda shoqatave dhe organizatave tjera joqeveritare.

**Neni 105**
**Greva**

1. Gjatë grevave, personat e angazhuar profesionalisht në mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera janë të detyruar të sigurojnë:

   1.1. veprim të pandërprerë të sistemit të monitorimit, paralajmërimit, alarmimit dhe komunikimit elektronik;

   1.2. veprim të pandërprerë të zbatimit të detyrave operative dhe teknike në mënyrë që të sigurohet veprimi i strukturave apo organeve tjera menaxhuese të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

2. Gjatë fatkeqësisë natyrore apo fatkeqësisë tjetër apo kur shpallet rreziku i pashmangshëm i ndodhjes së fatkeqësisë, personave nga paragrafi 1. i këtij neni u mohohet e drejta për hyrje në grevë.

3. Përdorimi i sinjaleve të alarmit dhe pajisjeve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës për qëllime të grevës është i ndaluar.

**KREU XII**
**ARSIMIMI DHE TRAJNIMI**

**Neni 106**
**Arsimimi**

1. Arsimi elementar siguron njohuri bazike mbi rreziqet nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe për mënyrën e mbrojtjes nga fatkeqësitë e tilla.

2. Arsimi sekondar dhe universitar siguron njohuri mbi mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në vartësi të fushës së arsimit.

**Neni 107**
**Trajnimet për mbrojtje personale dhe reciproke**

Trajnimi i banorëve për mbrojtje personale dhe reciproke dhe për zbatimin e masave mbrojtëse sigurohet nga niveli qendror dhe niveli lokal si trajnim jo i detyrueshëm.

**Neni 108**
**Trajnimi dhe ngritja profesionale**

1. Trajnimi i pjesëtarëve të SMSHN-së dhe shërbimeve tjera emergjente për kryerjen e detyrave në këtë fushëveprim duhet të përfshij trajnimet bazike dhe të avancuara.

2. Trajnimet bazike të pjesëtarëve të SMSHN-së dhe shërbimeve tjera emergjente nuk duhet t'i kalojnë pesëmbëdhjetë (15) ditë, ndërsa ato të avancuara nuk duhet t'i kalojnë pesë (5) ditë për vit.

3. Sipas rregullave trajnimet avancuese duhet të organizohen dhe realizohen në ditët e lira.

4. Pjesëtarët e SMSHN-së dhe shërbimeve tjera emergjente thirren në trajnime nëpërmjet mjeteve që përdoren për thirrje në aktivizim. Sipas rregullave, ftesa duhet tu dorëzohet atyre tridhjetë (30) ditë para fillimit të trajnimit.

**Neni 109**
**Mospjesëmarrja në trajnime**

1. Me kërkesën e tij, pjesëtarit të SMSHN-së i mundësohet lirimi i përkohshëm nga trajnimet kur ai:

1.1. është i paaftë të marr pjesë në trajnim për shkak të sëmundjes apo lëndimeve;

1.2. në kohën e thirrjes për pjesëmarrje në trajnim gjendet në shkollë apo kur për trajnimin në fjalë ai është caktuar të bëjë ndonjë kontroll, test apo merr pjesë në ushtrime të detyrueshme;

1.3. është duke u kujdesur për anëtarin e tij të familjes me ndonjë sëmundje të rëndë;

1.4. pas pranimit të thirrjes për pjesëmarrje në trajnim i ndodh rast vdekjeje në familje; apo

1.5. me pjesëmarrje në trajnim ai do të futet në situatë të vështir për shkak të arsyeve tjera.

2. Lirimi nga trajnimi mund të bëhet edhe për arsye të domosdoshmërisë në punë dhe aktiviteteve bujqësore

3. Kërkesa për mungesë në trajnim i dorëzohet organit përgjegjës, brenda tetë (8) ditëve nga data e thirrjes, përkatësisht nga data e ndodhjes së arsyes për mungesë.

**Neni 110**
**Qendra e trajnimeve**

1. Me qëllim të trajnimit dhe aftësimit profesional në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera themelohet Qendra e Trajnimeve te Integruara ne kuadër te Agjencisë së Menaxhimit Emergjent.

2. Qendra e Trajnimit është përgjegjëse për zbatimin e programeve të caktuara të trajnimeve për pjesëtarët e SMSHN-së dhe shërbimeve tjera emergjente pjesëtarëve të njësive, shërbimeve dhe strukturave tjera operative të shoqatave, organizatave joqeveritare dhe institucioneve tjera.

**Neni 111**
**Programet e Trajnimit**

1. Trajnimi dhe aftësimi profesional në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera duhet të organizohen në bashkëpunim me institucionet përkatëse qendrore dhe lokale

2. Ministria miraton zbatimin e programeve të trajnimit të përshtatura në bazë të obligimeve të shtetit në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në organizatat ndërkombëtare në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare.

3. Ministria me akt nënligjor përcakton programet e trajnimeve bazike dhe të avancuara, për pjesëtarët e njësive, shërbimeve, shoqatave, organizatave joqeveritare, institucioneve dhe ndërmarrjeve si dhe kushtet që duhet plotësuar organizatat që ofrojnë trajnime në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

**KREU XIII**
**FINANCIMI**

**Neni 112**
**Burimet financiare**

1. Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera financohet nga:

1.1. Buxheti i Republikës së Kosovës;

1.2. Buxheti i komunave;

1.3. këstet e sigurimeve;

1.4. kontributet vullnetare;

1.5. ndihmat ndërkombëtare;

1.6. burimet financiare të ndërmarrjeve, institucioneve dhe organizatave tjera;

1.7. burimet tjera.

**Neni 113**
**Shpenzimet e përgjithshme**

1. Aktivitetet administrative, teknike, mbikëqyrëse dhe aktivitetet tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera brenda kompetencave të shtetit financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

2. Financimin e aktiviteteve të lidhura me mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe çështjeve tjera në nivelin lokal e bëjnë organet lokale brenda kompetencave të tyre.

3. Organet në nivelin qendror dhe lokal në përputhje me përgjegjësitë e tyre sigurojnë burime financiare për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës të domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve, të mirave materiale dhe mjedisit.

4. Ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat tjera për të cilat kërkohet të organizojnë struktura për mbrojtje dhe shpëtim si dhe të zbatojnë masa dhe detyra që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, sigurojnë mjetet financiare për kompensimin e humbjeve të punëtorëve në aspektin e të hyrave gjatë trajnimeve sikurse edhe burimet financiare për t'i mbuluar shpenzimet për ushtrimet përgatitore dhe shpenzimet tjera lidhur me mbrojtjen.

5. Shpenzimet e operacioneve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në raste të aksidenteve të shkaktuara nga persona të panjohur mbulohen si shtesë nga niveli lokal ku ka ndodhur aksidenti i tillë, apo nga niveli qendror nëse detyrat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës janë nën përgjegjësinë e tij.

**Neni 114**
**Financimi i rimëkëmbjes dhe rindërtimit**

Burimet financiare për përfitimin e ndihmës për rindërtim dhe rimëkëmbje sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës me vendim të Qeverisë.

**Neni 115**
**Mbulimi i shpenzimeve**

1. Personi fizik apo juridik i cili me qëllim apo për shkak të neglizhencës shkakton kërcënim që përfundon me kosto të intervenimit emergjent apo shkakton një aksident është i obliguar t'i mbuloj shpenzimet e:

1.1. intervenimeve për mbrojtje dhe shpëtim;

1.2. rimëkëmbjes dhe sanimit;

1.3. dëmet e paguara për personat fizik dhe juridik.

2. Nëse kërcënimi apo aksidenti është shkaktuar nga më shumë se një person dhe nuk është i mundur identifikimi individual i tyre, ata janë përgjegjës për shlyerjen e shpenzimeve së bashku pa dallim.

3. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, çdo person fizik apo juridik i cili për shkak të neglizhencës, mungesës së trajnimeve apo për shkak të pajisjes jo adekuate shkakton kërcënim apo një aksident apo gjendje e cila ka rezultuar me shpenzime të intervenimeve emergjente, janë të obliguar t'i shlyejnë shpenzimet në mënyrë proporcionale pjesët e shpenzimeve të intervenimeve të përcaktuara nga Qeveria.

4. Qeveria i përcakton aktivitetet për të cilat pjesëmarrësit janë të obliguar të mbulojnë pjesën proporcionale të dëmit pa marr parasysh shkakun dhe përgjegjësinë për një aksident për të cilin pjesëmarrësit kanë nevojë për sigurim në aksident. Pjesa proporcionale e kostos intervenuese do të mbulohet nga një kompani e sigurimit apo vet pjesëmarrësit nëse nuk janë të siguruar.

5. Mjetet financiare të grumbulluara nga pagesat e intervenimeve emergjente apo intervenimeve proporcionale do të konsiderohen mjete të destinuara për shërbimin e shpëtimit apo strukturave operative të cilët kanë kryer intervenimin dhe mund të përdoren vetëm për aktivitetet e tyre sipas këtij ligji.

## KREU XIV
## DISPOZITAT NDËSHKIMORE

### Neni 116
### Gjobat

1. Me gjobë prej njëmijë (1.000) deri pesëmijë (5.000) Euro , dënohet personi fizik apo juridik, nëse:

1.1. nuk e lajmëron menjëherë qendrën më të afërt të alarmimit, njësinë policore apo të zjarrfikjes për rrezikun nga fatkeqësia natyrore apo fatkeqësia tjetër qoftë nëse e sheh vet apo njoftohet për të sipas neni 6 të këtij ligji;

1.2. nëse nuk i kryen apo në ndonjë mënyrë tjetër i ikën kryerjes së obligimeve materiale të përcaktuara në paragrafi 1. neni 25 të këtij ligji;

1.3. punëdhënësi e largon nga puna apo ja ndërron vendin e punës pjesëtarit të SMSHN apo qytetarit i cili vullnetarisht merr pjesë në zbatimin e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës sipas këtij ligji, apo shkakton çfarëdo dëmi tjetër për shkak të kryerjes së detyrave të përcaktuara në paragrafin 4. neni 27 të këtij ligji;

1.4. nëse në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nuk e lajmëron organin përkatës për ndryshimet e të dhënave të përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji;

1.5. nëse nuk siguron kushte apo mundësi për realizimin e mbrojtjes personale dhe reciproke të punëtorëve, apo nuk i realizon masat e parapara mbrojtëse të përcaktuara në paragrafin 1. neni 38 të këtij ligji;

1.6. nëse në procesin e punës përdor, prodhon, transporton apo deponon materie të rrezikshme, naftë dhe derivate të saj dhe nëse kryen aktivitete ose punon me mjete të prodhimit që paraqesin rrezik për ndodhjen e fatkeqësive, apo nuk bën vlerësimin e rrezikut dhe planin e reagimit emergjent sipas paragrafi 2. të nenit 38 të këtij ligji;

1.7. nëse në relacion me gjerësinë dhe shkallën e rrezikut, me shpenzimet e tija nuk themelon dhe mirëmban gatishmërinë për veprim apo nuk bënë organizimin e forcave të nevojshme për shpëtim dhe ndihmë apo nuk siguron njoftim dhe alarmim të punëtorëve dhe popullatës përreth, për rrezikun apo nuk bënë bashkëfinancimin e aktiviteteve përgatitore të ndërmarrjeve fqinje, institucioneve dhe organizatave tjera apo organeve lokale proporcionalisht me rrezikun e krijuar nga aktiviteti i tij sipas paragrafit 3. të nenit 38 të këtij ligji;

1.8. nuk bënë përpunimin e planeve të reagimit emergjent apo nuk bënë planifikimin e zbatimit të masave të mbrojtjes dhe detyrave të caktuara të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera të përcaktuara në paragrafin 4. të nenit 38 të këtij ligji;

1.9. nëse si pronar ose shfrytëzues i ndërtesave të banimit apo i ndërtesave të tjera nuk ndërmerr masa të parapara mbrojtëse, apo nuk siguron mjete të parapara mbrojtëse për shpëtim dhe ndihmë sipas paragrafit 1. të nenit 39, apo nëse nuk ndërmerr masa të parapara për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe mjedisit sipas paragrafit 2. të nenit 39 të këtij ligji;

1.10. nëse si pronar apo shfrytëzues i ndërtesave banesore, apo ndërtesave të tjera nuk ndihmon punën e përgjegjësit kompetent të mbrojtjes dhe shpëtimit, apo nuk i ofron atij të dhënat për ndërtesën, ose të dhënat për banorë dhe shfrytëzues të tjerë të ndërtesës sipas paragrafit 3. të nenit 39 të këtij ligji;

1.11. nëse me kërkesën e Kryetarit të Komunës nuk i harton planet e reagimit emergjent të përcaktuara në paragrafin 3. të nenit 46 të këtij ligji;

1.12. nëse si pronar apo shfrytëzues i objekteve të destinuara për furnizim publik me ujë, për prodhim, transport apo deponim të ushqimit, medikamenteve apo ushqimit të kafshëve, shërbimeve publike shëndetësore apo kujdesit dhe edukimit të fëmijëve, nuk siguron mjete mbrojtëse apo nuk zbaton masat e përcaktuara për mbrojtje radiologjike, kimike dhe biologjike sipas paragrafit 2. të nenit 61 të këtij ligji;

1.13. nëse si investitor nuk siguron ndërtim të strehimoreve sipas dispozitave të nenit 64 të këtij ligji;

1.14. nëse si pronar apo shfrytëzues i strehimoreve nuk mirëmban ato në gjendjen që përputhet me qëllimin e tyre, apo në rast të emergjencës nuk ua mundëson qasjen apo përdorimin e këtyre personave, për të cilët është e destinuar ajo sipas dispozitave të nenit 65 të këtij ligji;

1.15. nëse nuk bën organizimin përkatës për kryerjen e detyrave apo nuk kujdeset për aftësimin profesional të punëtorëve të tij ose nuk ndërmerr përgatitje të tjera për veprim në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera sipas paragrafit 2. të nenit 73 të këtij ligji;

1.16. nëse pengon zbatimin e masave apo nëse nuk vepron në përputhje me masat e përcaktuara gjatë menaxhimit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga Komandanti i Incidentit të përcaktuara në paragrafët 1.,3. dhe 4. të nenit 82 të këtij ligji;

1.17. nëse i kopjon, apo në mënyrë të paligjshme i përdor shenjat dhe uniformën SMSHN-së, apo i kopjon dhe i përdor në qarkullim rrugor automjetet e ngjashme me automjetet dhe mjetet tjera transportuese të SMSHN-së, sipas paragrafi 2. të nenit 86 të këtij ligji;

1.18. nëse vepron në kundërshtim me masat e shqiptuara nga Zyra e Inspektorit Kryesor të AME-së sipas dispozitave të nenit 95 të këtij ligji.

2. Me gjobë prej njëqind (100) deri dyqindepesëdhjetë (250) Euro, dënohet personi përgjegjës i personit juridik, apo personi përgjegjës i personit të vetëpunësuar nëse vepron në kundërshtim me paragrafin 1. të këtij neni.

**Neni 117**

Me gjobë prej njëmijë (1000) deri njëmijepesëqind (1.500) Euro, për kundërvajtje dënohet ndërmarrja, institucioni apo organizata, nëse nuk vendosin, mirëmbajnë dhe sigurojnë funksionimin e aparateve për paralajmërimin e popullatës apo nëse aparatet e tilla nuk i integrojnë në sistemin publik të alarmimit të përcaktuara në paragrafin 3. të nenit 38 të këtij ligji.

**Neni 118**

1. Me gjobë prej njëmijë (1.000) deri njëmijepesëqind (1.500) Euro, për kundërvajtje dënohet personi përgjegjës i organit qendror apo lokal nëse:

1.1. nuk bënë vlerësimin e rreziqeve për zonën e tij të përgjegjësisë sipas paragrafit 2., nën-paragrafi 2.5. të nenit 37 të këtij ligji;

1.2. nuk i punon planet lokale të reagimit emergjent sipas paragrafit 2., nën-paragrafi 2.5. të nenit 37 të këtij ligji;

**Neni 119**

1. Me gjobë prej dyqind (200) deri pesëqind (500) Euro, për kundërvajtje dënohet personi i cili:

1.1. në cilësinë e pjesëtarit të SMSHN-së nuk e kryen, apo i ikën pa arsye pjesëmarrjes në struktura sipas paragrafit 1. të nenit 16 të këtij ligji;

1.2. në cilësinë e pjesëmarrësit vullnetar, në SMSHN nuk trajnohet për kryerjen e detyrave në përputhje me rregulloret sipas paragrafit 3. të nenit 16 të këtij ligji;

1.3. nuk i përmbush obligimet materiale duke i vënë në dispozicion të SMSHN-së, për përdorim automjetet, makineritë, pajisjet dhe mjetet tjera materiale, objektet, ndërtesat, mjetet dhe burimet e energjisë të nevojshme për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, sipas paragrafit 1. të nenit 25 i këtij ligji;

1.4. pa arsyetim, nuk lajmërohet në kohën apo vendin e caktuar, apo nuk dorëzon mjetet materiale me kërkesën e përgjegjësit sipas paragrafit 1. të nenit 26 të këtij ligji;

1.5. në cilësinë e pronarit apo shfrytëzuesit të shtëpisë së banimit me kërkesën e kryetarit të Komunës refuzon strehimin e banorëve të evakuuar dhe njerëzve në rrezik sipas paragrafit paragrafi 2. të nenit 60 të këtij ligji;

2. Me gjobë prej njëmijë (1.000) deri njëmijepesëqind (1.500) Euro, për kundërvajtje dënohet personi i cili pengon zbatimin e masave apo nuk vepron në përputhshmëri me masat e caktuara nga Komandanti i Incidentit gjatë menaxhimit të mbrojtjes dhe shpëtimit të përcaktuara në paragrafët 1., 3., 4. të nenit 82 të këtij ligji

## KREU XV
## DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

### Neni 120
### Nxjerrja e akteve nënligjore

Organet e përcaktuara me këtë ligj janë të obliguara të nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, më së largu një (1) vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

### Neni 121
### Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, shfuqizohet Ligji Nr. 02/L-68 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera.

### Neni 122
### Hyrja në fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-027**
**22 shtator 2011**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-037-2011, datë 07.10.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.**